Burimet njerëzore janë mjaft të rëndësishme për organizimin e aktiviteteve, angazhimin e grupeve të interesit dhe çuarjen e nismave përpara. Rekrutimi i individëve të aftë dhe të pasionuar është mjaft i rëndësishëm për të katalizuar kalimin drejt një sistemi ushqimor të qëndrueshëm. Ngarkesa e punës dhe disponueshmëria e njerëzve që punojnë në çështjet e ushqimit në nivel bashkie është shpesh një sfidë. Në shumë raste, ekipi që merret me këto çështje është i vogël. Për më tepër, fare pak bashki kanë një departament tërësisht të dedikuar për ushqimin. Kjo bën që njerëzit të shpërndahen në sektorë të ndryshëm si mjedisi, bujqësia dhe shëndetësia. Nga njëra anë, kjo mund të shihet në një aspekt pozitiv, pasi nismat për ushqimin kërkojnë një perspektivë holistike dhe kjo qasje horizontale sjell bashkë njohuri, vizione dhe perceptime të ndryshme që mund të jenë të dobishme. Nga ana tjetër, ky fragmentim paraqet pengesa të mëtejshme për t'u kapërcyer, të tilla si mungesa e komunikimit, koha shtesë, vështirësitë në koordinim dhe mungesa e një qasjeje sistematike.

Krijimi i një "ekipi ushqimor" të dedikuar në bashki, i përbërë nga anëtarë të pasionuar dhe kompetentë, mund të rrisë shumë efektivitetin në trajtimin e problemeve specifike. Në rastet kur kapaciteti i personelit është i kufizuar, lind nevoja të përcaktohen fushat e ndërhyrjes brenda kontekstit më të gjerë të sistemit ushqimor, bazuar në aftësitë dhe kompetencat që zotëron ekipi. Prioritizimi bëhet mjaft i rëndësishëm në rastet e mungesës së personelit. Gjithashtu, mund të krijohen lidhje me aktivitetet ekzistuese për të nxitur bashkëpunimin dhe për të përmirësuar ndarjen e burimeve. Bashkëpunimi me organizatat e jashtme, universitetet dhe komunitetet mund ta lehtësojë barrën duke e ndarë ngarkesën e punës, duke rritur kështu kapacitetin e ekipit për të arritur qëllimet e tij. Pasiguritë në kuadrin kontraktues të punës, duke përfshirë kontratat afatshkurtra, mund të pengojnë planifikimin dhe stabilitetin afatgjatë.



Identifikoni dhe lidhuni me nismat ekzistuese. Kjo do t'ju kursejë kohë duke shmangur dyfishimin e përpjekjeve dhe do t'ju ofrojë mundësi për t'u lidhur dhe për të mësuar nga përvojat e tjera.

 Blloqet e ndërtimit > 2.4 Burimet > 3. Njohuritë dhe ekspertiza për ushqimin



### 3. Mbushja e boshllëqeve në aftësi dhe njohuri në novacionin e sistemit ushqimor përmes bashkëpunimit me ekspertë

Anëtarët e personelit që kanë aftësi dhe njohuri, të cilët punojnë për tranzicionet ushqimore urbane, mund të përfitojnë ndjeshëm nga planet dhe proceset. Zhvillimi i kompetencave brenda ekipit përmes seminareve, trajnimeve dhe mësimet nga kolegët ofron përparësi të shumta. Megjithatë, disa qytete përballen me sfida në rekrutimin e personelit të përshtatshëm, veçanërisht në fushën e specializuar të mjediseve ushqimore, gjë që kërkon një kombinim unik të njohurive dhe të ekspertizës.

Për ta zgjidhur këtë, është mjaft e rëndësishme të vlerësohet përbërja e ekipit dhe të identifikohen fushat ku mund të mungojë ekspertiza. Kjo ju lejon të kuptoni se cilat veprime mund të prioritizohen dhe të kryhen brenda bashkisë dhe cilat janë më mirë të kryhen nga palë të kontraktuara. Aty ku ekspertiza është e kufizuar, duhet të thirren ekspertë të jashtëm të specializuar në çështje të tilla si kontratat, rregulloret, komunikimi, ushqimi, prokurorimi, qeverisja etj.

Përveç kësaj është edhe mundësia e bashkëpunimit me institutet kërkimore dhe universitetet që mund të mbështesin ekipin bashkiak me njohuri shkencore. Kjo mund të jetë mjaft e rëndësishme në fazat e hershme të planifikimit dhe matjes së ndikimeve duke mbledhur dhe analizuar të dhënat nga aktivitetet.

Për më tepër, investimi në trajnim është thelbësor për kultivimin e punonjësve të rinj të aftë dhe të përhershëm. Kjo jo vetëm që nxit shkëmbimin e njohurive, por siguron edhe stabilitetin e ekipit, duke reduktuar mbështetjen të specialistëve individualë. Transferimi horizontal i njohurive dhe rritja e aftësive brenda ekipit shfaqen si burime të paçmueshme për përparim të qëndrueshëm.



Krijoni marrëdhënie bashkëpunimi me profesionistë për të kompensuar mungesën e ekspertizës në bashki, duke kursyer kohë dhe energji.



Blloqet e ndërtimit > 2.5 Aktivitetet



## 2.5 AKTIVITETET

Themeli për sistemet ushqimore bashkiake qëndron në aktivitetet e ndërmarra, të cilat kërkojnë planifikim të kujdesshëm, vizion, zbatim dhe monitorim.

Ngaqë sistemi ushqimor përfshin disa fusha, ndërhyrjet dhe veprimet e mundshme mund të ndryshojnë shumë.

Është thelbësore që qasja me veprimet tuaja ndaj sistemit ushqimor të bëhet gjithmonë në mënyrë holistike.



Elementet e mëposhtme për kalimin drejt një sistemi ushqimor më të qëndrueshëm janë mjaft të rëndësishme:

1

### Nismat edukative:

Përmirësimi i ndërgjegjësimit të qytetarëve për ushqimin përmes aktiviteteve edukative

2

### Reduktimi i ushqimit të mbetur:

Zbatimi i masave për menaxhimin efektiv të ushqimit të mbetur në nivel bashkie

3

### Prodhimi vendor i ushqimit:

Nxitja e një sistemi më të qëndrueshëm dhe vendas të prodhimit të ushqimit

4

### Dhurimi dhe rishpërndarja e ushqimit:

Përmirësimi i sistemit të dhurimit të ushqimit për të promovuar gjithëpërfshirjen



Blloqet e ndërtimit > 2.5 Aktivitetet > 1. Nismat edukative



## 1 Përmirësimi i ndërgjegjësimit të qytetarëve përmes aktiviteteve edukative

Shumë qytete e pranojnë rolin e rëndësishëm që ka edukimi dhe ndërgjegjësimi për ushqimin për të arritur rezultate në sistemet e tyre ushqimore urbane. Krijimi i aktiviteteve edukative në shkolla është një mënyrë efektive për të nxjerrë në pah lidhjen bazë midis ushqimit, klimës, mjedisit dhe shëndetit të rinjtë dhe për të lehtësuar transmetimin e tij ndër breza. Për të promovuar praktika të mira përtej mureve të shkollës, qytetet mund të angazhojnë nxënësit me qëllim formimin e sjelljeve të ndryshme dietike në familje. Objektivi përfundimtar është rritja e ndërgjegjësimit jo vetëm midis fëmijëve, por edhe në të gjithë komunitetin më të gjerë. Duke zhvilluar aktivitete në shkolla dhe veçanërisht në mensat e shkollave, qytetet bëjnë të mundur që fëmijëve t'u jepet ushqim i shëndetshëm dhe me vlera ushqyese, duke u siguruar kështu që të gjithë nxënësit të marrin të paktën një vakt të plotë dhe të ekuilibruar në ditë.

Shkollat kontribuojnë në veçanti për futjen e zakoneve të reja të të ngrënit, të tilla si rritja e opsioneve vegjetariane, megjithëse ato mund të hasin rezistencë nga prindërit dhe industria e mishit. Komunikimi efektiv, duke përfshirë udhëzimet nga ekspertë të tillë si nutricionistët, është mjaft i rëndësishëm për tejkalimin e këtyre sfidave.

Shumë qytete të Food Trails zbatuan ndërhyrje në mensat e shkollave duke rishikuar menutë për të promovuar konsumin e perimeve dhe për të reduktuar ushqimin e mbetur. Nisma të tjera përfshijnë pjesëmarrjen e fëmijëve në aktivitetet e gatimit në mensat shkollore ([Kopenhagë](#)), krijimin e kopshteve shkollore ([Bergamo](#)), ofrimin e mëngjeseve në kopshtet e fëmijëve (Tiranë) dhe ofrimin e kurseve të gatimit dhe librave me receta ([Groningen](#)). Këta shembuj nënvizojnë angazhimin e qyteteve për të promovuar zakone më të shëndetshme të të ngrënit dhe për të nxitur qëndrueshmërinë në komunitetet e tyre duke filluar me brezin e ri.



Për të arritur një ndikim më të gjerë dhe të qëndrueshëm, në aktivitetet edukative përfshini jo vetëm nxënësit, por edhe prindërit dhe komunitetin më të gjerë.





Bllloqet e ndërtimit > 2.5 Aktivitetet > 2. Reduktimi i ushqimit të mbetur



## 2 Zbatimi i masave për menaxhimin efektiv të ushqimit të mbetur në nivel bashkie

Menaxhimi i ushqimit të mbetur është shfaqur si një shtyllë mjaft e rëndësishme në shumë qytete të Food Trails, pasi është thelbësor për zbutjen e ndikimit të tyre mjedisor në zonat urbane. Ndërsa shpesh përpjekjet përqendrohen në përmirësimin e rishpërndarjes së ushqimit, po aq i rëndësishëm është edhe parandalimi i krijimit të mbetjeve. Jo të gjitha ushqimet e dhuruara mund të rishpërndahen, veçanërisht artikujt e dëmtuar ose të prishur. Për këtë arsye, qytetet duhet të eksplorojnë zgjidhje alternative, të tilla si përdorimi i mbetjeve për prodhimin e energjisë përmes biotretësve ose shndërrimi i tyre në pleh. Bashkëpunimi me sektorin privat, duke përfshirë bizneset, supermarketet dhe restorantet, është mjaft i rëndësishëm për mbledhjen dhe reduktimin efektiv të mbetjeve: bashkia mund t'i mbështesë ato për të zhvilluar strategji të përmirësuara për menaxhimin e mbetjeve.

Menaxhimi i ushqimit të mbetur kërkon njohuri të hollësishme për shtrirjen e këtij problemi. Ju mund të bashkëpunoni me organizata ekspertësh ose të kryeni fushata periodike analizuese për të vlerësuar prodhimin e mbetjeve të qytetit.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme në fillimin e një nisme. Për më tepër, mungesa e prioritizimit nga administratat e qytetit dhe rregulloret joadekuate mund të pengojnë përpjekjet efektive për menaxhimin e mbetjeve. Organizimi i seminareve mund të përmirësojë grumbullimin e mbetjeve shtëpiake, ndërsa krijimi i një platforme gjithëpërfshirëse që lidh prodhuesit e ushqimit me njerëzit në nevojë lehtëson përpjekjet për rishpërndarje. Përveç kësaj, krijimi i qendrave të ushqimit të mbetur që shërbejnë si qendra grumbullimi, pika shpërndarjeje dhe biotretës përmirëson menaxhimin e mbetjeve në qytet.

Nismat pozitive për reduktimin, parandalimin dhe menaxhimin e mbetjeve gjatë projektit Food Trails përfshijnë rishikimet e menyve e teknikat e stimulimit në mensat shkollore dhe krijimin e qendrave të grumbullimit e të rishpërndarjes së tepricave të ushqimit ([Milano](#)), zvogëlimin e madhësisë së porcioneve në shkolla ([Kopenhagë](#)), edukimin e industrisë së shërbimit të ushqimit mbi kornizën ligjore dhe thjeshtimin e procedurave rreth dhurimeve të tepricave të ushqimit ([Varshavë](#)) dhe krijimin e plehëruesve mbështetur nga komuniteti duke përdorur mbetjet e ushqimit shtëpiake ([Birmingham](#)).



Hartoni rolet e të gjithë aktorëve të përfshirë në menaxhimin e mbetjeve bashkiake.

 Blloqet e ndërtimit > 2.5 Aktivitetet > 3. Prodhimi vendor i ushqimit

### 3 Nxitja e një sistemi më të qëndrueshëm dhe vendor të prodhimit dhe shpërndarjes së ushqimit

Zinxhirët vendorë të ushqimit mund të luajnë një rol kyç në formimin e sistemit ushqimor urban të një qyteti. Prioritizimi i produkteve vendore jo vetëm që zvogëlon emetimet e prodhimit të ushqimit dhe logjistikën, por gjithashtu rrit ekonominë vendore, duke forcuar lidhjet midis aktorëve të shumtë në zinxhirin e furnizimit. Disponueshmëria e kufizuar e tokës është një sfidë. Qytetet mund të eksplorojnë teknika novatore të bujqësisë, të tilla si akuaponika, bujqësia hidroponike dhe vertikale, si dhe kopshtet kolektive, fermat e vogla dhe bujqësia urbane. Angazhoni prodhuesit në diskutimet vendore për politikën ushqimore për të nxitur novacionin dhe për të rritur ndërgjegjësimin për mundësitë përkatëse.

Bashkia duhet të kuptojë realitetin dhe nevojat e këtij sektori dhe më pas të veprojë si koordinator për të përmirësuar njohuritë e prodhuesve rreth novacionit. Për shembull, përveç ofrimit të subvencioneve, një mundësi është organizimi i seminareve mbi bujqësinë organike dhe teknikat novatore të kultivimit.

Gjithashtu, bashkia duhet të mbështesë krijimin e rrjeteve të shpërndarjes për të lehtësuar logjistikën e prodhimeve vendore dhe të ofrojë ndihmë ligjore e financiare për t'i nxitur fermerët të marrin pjesë në projekte të reja ose programe novacioni, duke garantuar një sistem ushqimor vendor që lulëzon.

Përveç promovimit të prodhimit vendor, qytetet duhet t'i japin përparësi bujqësisë së qëndrueshme urbane dhe periurbane. Në Food Trails, disa qytete kanë krijuar kopshte urbane për qytetarët dhe studentët, si Bergamo dhe Funshali, ose kanë mbështetur aktivisht nismat e prodhimit të qëndrueshëm të ushqimit në komunitet, si Groningeni. Është e rëndësishme të mbështeten prodhuesit që zbatojnë metoda agro-ekologjike novatore dhe të shfrytëzohen praktikrat e sigurimit të qëndrueshëm publik të ushqimit për të mbështetur bujqësinë urbane dhe zinxhirët vendorë të furnizimit, si p.sh. në Bordeaux Metropoledhe Milano. Së fundi, zhvillimi dhe mbështetja e sistemeve vendore të prodhimit dhe shpërndarjes mund të forcojë marrëdhëniet e bashkëpunimit urban-urban midis konsumatorëve dhe prodhuesve, si p.sh. në Metropolin e Grenobles së Alpeve.



Sigurohuni që t'i përfshini fermerët në çdo hap të procesit të tranzicionit.

 Blloqet e ndërtimit > 2.5 Aktivitetet > 4. Dhurimi dhe rishpërndarja e ushqimit

## 4 Përmirësimi i sistemit të dhurimit të ushqimit për të promovuar gjithëpërfshirjen

Rishikimi i sistemit të rishpërndarjes së ushqimit të dhuruar ishte një aktivitet i rëndësishëm për qytetet e përfshira në projektin Food Trails, pasi ndërthur objektivat e reduktimit të ushqimit të mbetur dhe të ofrimit të mbështetjes për njerëzit në nevojë. Kjo duhet të shihet në kontekstin e mundësisë të qasjes në ushqim të shëndetshëm dhe me vlera ushqyese për të gjithë, pa lënë askënd pas. Angazhimi politik dhe rregulloret mbështetëse ndikojnë ndjeshëm në efektivitetin e nismave të tilla. Krijimi i një rrjeti të fuqishëm dhurimesh që përfshin restorante, supermarkete, mensa dhe kompani është thelbësor për përmirësimin e bashkëpunimit dhe marrjen e ushqimeve të dhuruara që janë në gjendje më të mirë të pranueshme për rishpërndarje. Fushatat e komunikimit mund të rrisin ndërgjegjësimin dhe të nxisin më shumë kompani e individë të marrin pjesë në sigurimin e ushqimit për të gjithë, duke nxitur një ndryshim kulturor drejt një sistemi ushqimor më të qëndrueshëm për të gjithë.

Duke pasur parasysh mbështetjen e fortë të sistemit të rishpërndarjes të vullnetarët, trajnimi i vazhdueshëm është thelbësor për të garantuar stabilitet brenda sistemit dhe për të siguruar që njerëzit të mund t'i përmbushin rolet e tyre në mënyrë efektive.

Edhe pse bashkia mund të luajë një rol në hartimin e strategjive të shpërndarjes, zbatimi është zakonisht përgjegjësi e organizatave të sektorit të tretë dhe OJQ-ve. Bashkëpunimi me organizata të tilla është thelbësor për krijimin e një sistemi të fuqishëm dhe të vetëqëndrueshëm, i cili gjithashtu ndikon në menaxhimin e bankave ushqimore të qytetit. Për më tepër, krijimi i një rrjeti organizatash me kapacitet për të mbledhur dhe për të rishpërndarë në mënyrë efektive ushqimin është vendimtar, veçanërisht për shkak të ndryshueshmërisë së furnizimeve dhe rëndësisë së kohës në shpërndarjen e ushqimit.

Gjatë Food Trails, disa qytete u përqendruan në sistemet e rishpërndarjes së ushqimit: Varshava pati një fluks refugjatësh ukrainas për shkak të luftës dhe u desh të zhvillonte një sistem efikas, pragmatik dhe të imitueshëm; Tirana punoi për ta bërë ushqimin e shëndetshëm më të arritshëm veçanërisht për më nevojtarët dhe Funshali bashkëpunoi ngushtë me lagjet sociale, duke shpërndarë qese me ushqime të mbetura bashkë me udhëzime për përgatitjen e vakteve me vlera ushqyese me pak përbërës.



Përcaktoni udhëzime të qarta për ushqimet e dhuruara për t'u siguruar që të jenë të sigurta, me vlera ushqyese dhe të përshtatshme për rishpërndarje dhe sigurohuni që ato të kuptohen mirë nga bizneset ushqimore.



Bllloqet e ndërtimit > 2.6 Të mësuarit



## 2.6 TË MËSUARIT

Udhëtimi i një qyteti drejt një sistemi të përmirësuar ushqimor urban përfshin angazhimin në aktivitete dinamike të të mësuarit. Për t'i bërë risitë të funksionojnë në një shkallë më

të gjerë, është e rëndësishme të ndani njohuritë dhe praktikat dhe t'i zbatoni ato në kontekste të ndryshme, duke stimuluar të mësuarit nga kolegët dhe bashkëpunimin.



Elementet e mëposhtme janë thelbësore për të mësuarit efektiv nga kolegët dhe transferimin e njohurive:

1

### Shkëmbimi i njohurive:

Lehtësimi i shkëmbimit të njohurive dhe informacionit për të stimuluar imitimin e përvojave pozitive

2

### Si të frymëzoheni:

mësoni nga përvojat e qyteteve të tjera për të zhvilluar dhe zgjeruar nisma të ngjashme



Blloqet e ndërtimit > 2.6 Të mësuarit > 1. Shkëmbimi i njohurive



## 1 Lehtësimi i shkëmbimit të njohurive dhe informacionit për të stimuluar imitimin e përvojave pozitive

Gjatë Food Trails, qytetet takohen shpesh me njëri-tjetrin për të shkëmbyer përvoja. Transferimi i njohurive mbi risitë e sistemit ushqimor mund të jetë i vlefshëm për qytetet e tjera në procesin e fillimit të udhëtimeve të ngjashme. Të mësuarit e përbashkët mund të ndodhë në forma të ndryshme, siç janë prezantimet, seminarët, vizitat, diskutimet dhe eventet. Qytetet pjesëmarrëse në projektin Food Trails theksuan avantazhet e shkëmbimeve ballë për ballë, duke vënë në dukje më shumë mundësi për rrjetëzim.

Shkëmbimi i informacionit është baza për imitimin e praktikave të mira. Së pari, kuptoni dhe mblidhni informacione nga kontekste të tjera, pastaj merrni parasysh se si ta përshtatni përvojën e fituar në qytetin tuaj.

Të mësuarit e përbashkët lehtëson shkëmbimin e njohurive mbi tema specifike, të cilat mund të kursejnë burime në fazat fillestare të proceseve të transformimit të sistemit ushqimor. Përmes angazhimit me të tjerët, ju mund të kuptoni më mirë përparësitë tuaja dhe të vlerësoni burimet e disponueshme në kontekstin tuaj.

Një kulturë e përbashkët bazë dhe interesat e përbashkëta ndihmojnë për t'u lidhur. Në fakt, shkëmbimet janë më efektive kur qytetet kanë gjëra të përbashkëta, siç janë objektivat, kornizat ligjore ose aktivitetet e ngjashme. Të kesh të dhëna nga të tjerët ndihmon, veçanërisht për qytetet që sapo kanë filluar një proces transformimi. Gjatë diskutimeve, mund të jetë më e thjeshtë të përqendrohesh në aspektet operacionale të transformimit, ndërsa ndarja e problemeve të sistemit, si p.sh. qeverisja, mund të jetë më komplekse. Së fundi, informacioni i marrë mund të ndahet dhe të shpërndahet në një nivel më të lartë në qytet, për të rritur njohuritë.



Shkëmbimi i njohurive dhe përvojave rrit mundësinë e imitimit të suksesshëm të aktiviteteve.





Blloqet e ndërtimit > 2.6 Të mësuarit > 2. Frymëzimi



## 2 Mësoni nga përvojat e qyteteve të tjera për të zhvilluar dhe zgjeruar nisma të ngjashme

Ndërveprimet ngjallin frymëzim për ide të reja që mund të përshtaten në kontekste të ndryshme. Edhe nëse këto ide nuk vihen menjëherë në veprim, mund të shërbejnë si burime të vlefshme frymëzimi për të ardhmen, edhe sikur zbatimi përfundimtar të ndryshojë nga koncepti origjinal. Për shembull, [Groningeni](#) zhvilloi një libër gatimi për fëmijët dhe familjet frymëzuar nga puna e Birminghamit për politikën e tyre ushqimore, ndërsa [Bergamo](#) krijoi kopshte shkollore frymëzuar nga puna e Funshalit për këtë temë. Nxjerrja e mësimave nga këto ndërveprime mund të përmirësojë nismat ekzistuese dhe të nxisë eksplorimin e modeleve të reja.

Procesi i shkëmbimit të njohurive nuk është i kufizuar te ndërveprimet midis qyteteve; ai mund të ndodhë edhe midis departamenteve të ndryshme brenda një qyteti ose të nxitet nga aktivitetet e nisura nga organizatat.

Natyrisht, çdo ide duhet të përshtatet me kontekstin specifik. Përshtatja varet nga shumë faktorë, duke përfshirë strukturat e qeverisjes, kornizat ligjore, disponueshmëria e burimeve, kontekstet kulturore, nivelet e përfshirjes së komunitetit dhe mundësitë e financimit.

Shkëmbimet ndihmojnë për të treguar se si trajtohen sfida të ngjashme në kontekste të tjera, edhe pse në rrethana të ndryshme. Kjo mund të çojë në reflektim se si t'i përballojë këto sfida brenda sistemit tuaj ushqimor, veçanërisht kur mësoni nga një qytet që i ka kapërcyer me sukses pengesat. Frymëzimi nga përvojat e tyre mund të thjeshtojë kërkimin e zgjidhjeve. Qasja në udhëzimet e dikujt që tashmë ka përshtatur terren të ngjashëm mund të jetë jashtëzakonisht e vlefshme në përballimin e këtyre sfidave.



Përdorni përvojat e të tjerëve si frymëzim për aktivitetet e ardhshme. Edhe nëse burimet dhe koha aktualisht janë të pamjaftueshme për t'i zbatuar, këto ide mund të ruhen derisa të ndryshojnë kushtet.

## 3. SHEMBUJ





Shembujt e përfshirë në këtë manual janë disa nga mënyrat se si qytetet e Food Trails kanë punuar në temat prioritare të Paktit të Politikës Ushqimore Urbane të Milanos. Çdo shembull vlerësohet në kategoritë e Ushqimit 2030 që ata trajtojnë:

klima, ushqimi, qarkullimi dhe komuniteti. Megjithatë, është e rëndësishme të mbani mend se shumica e ndërhyrjeve në sistemin ushqimor ka të bëjnë me tema dhe kategori të shumta prioritare në të njëjtën kohë.



### QEVERISJA

Përmirësimi i sistemeve ushqimore urbane kërkon ndryshimin e mënyrës se si bashkitë marrin vendime, organizohen dhe punojnë me grupet e tjera të interesit. Kjo përfshin bashkëpunim më të mirë midis agjencive dhe departamenteve të qytetit, bashkëkrijimin ose rishikimin e politikave për ushqimin, krijimin e një këshilli gjithëpërfshirës, përfaqësues për politikën ushqimore dhe identifikimin, hartëzimin dhe mbështetjen e nismave vendore dhe bazë.



### USHQIMI I MBETUR

Bashkitë mund të mbështesin hapësirat publike të ngrënies dhe furnizuesit e tyre me shumicë mund të ndihmojnë për monitorimin dhe pakësimin e ushqimit të mbetur. Përpjekjet në mbarë qytetin mund të përfshijnë edukimin publik dhe mundësitë për krijimin dhe përdorimin e ushqimit të mbetur të kthyer në pleh, si dhe garantimin që legjislacioni dhe udhëzimet për përdorimin e ushqimit të mos nxitin mbetje të panevojshme të ushqimit.



### PRODHIMI I USHQIMIT

Qytetet mund të forcojnë prodhimin e qëndrueshëm të ushqimit duke promovuar lidhjet rurale-urbane, duke përdorur një qasje të ekosistemit për të udhëhequr planifikimin dhe menaxhimin e përdorimit të tokës, duke garantuar qasje të sigurt të tokës për prodhim të qëndrueshëm të ushqimit dhe duke u siguruar prodhuesve ushqimorë urbanë dhe periurbanë mbështetje materiale dhe logjistike.



### DIETAT DHE TË USHQYERIT E QËNDRUESHËM

Dietat e qëndrueshme janë të mira për shëndetin publik, mirëqenien dhe për mjedisin. Qytetet mund të promovojnë edukimin e qëndrueshëm dietik dhe aftësitë e gatimit për publikun e gjerë dhe ata që punojnë në sektorin e ushqimit, dhe të eksplorojnë instrumente rregullatore dhe vullnetare për të promovuar dieta të qëndrueshme të përbalueshme dhe të përshtatshme nga ana kulturore.



### FURNIZIMI DHE SHPËRNDARJA E USHQIMIT

Qytetet mund të promovojnë qëndrueshmërinë përmes përmirësimit të lidhjeve dhe transportit midis zonave urbane, periferike dhe zonave të afërta të prodhimit të ushqimit. Sistemet e prokurimit mund të nxisin prodhimin agroekologjik të ushqimit dhe mundësitë e tregut për prodhuesit rajonalë. Mbështetja e tregjeve bashkiake lidh drejtpërdrejt prodhuesit dhe konsumatorët përmes zinxhirëve të shkurtër të furnizimit.



### BARAZIA SOCIALE DHE EKONOMIKE

Problemet e sistemit ushqimor urban shpesh lidhen me pabarazinë sociale dhe ekonomike. Qytetet duhet të përfshijnë nisma ushqimore brenda aktiviteteve sociale dhe solidaritetit. Promovimi dhe mbështetja e qasjeve bazë dhe inovative ndihmon në sigurimin e qasjes së barabartë në ushqim të shëndetshëm për të gjithë.



3. Shembuj > 3.1 Qeverisja



## 3.1 QEVERISJA

Përmirësimi i sistemeve ushqimore urbane kërkon ndryshimin e mënyrës se si bashkitë marrin vendime, organizohen dhe punojnë me grupet e tjera të interesit. Kjo përfshin bashkëpunim më të mirë midis agjencive dhe departamenteve të qytetit,

bashkëkrijimin ose rishikimin e politikave për ushqimin, krijimin e një këshilli gjithëpërfshirës, përfaqësues për politikën ushqimore dhe identifikimin, hartëzimin dhe mbështetjen e nismave vendore dhe bazë.



Qytetet e Food Trails kanë punuar për pyetjet e mëposhtme rreth qeverisjes:

1

Si mund të përfshijë qyteti im sa më shumë grupe interesi në përballimin e sfidave të sistemit ushqimor?  
Bordeaux Metropole

2

Si mund të sigurohet qyteti im që politika jonë ushqimore të jetë e lidhur me kontekstin e saj më të gjerë politik dhe ekonomik?  
Birminghami

3

Si mund t'i bëjë qyteti im të punojnë së bashku përfaqësuesit nga departamentet e shumta bashkiake dhe organizatat e jashtme?  
Selaniku



## 3. Shembuj &gt; 3.1 Qeverisja &gt; Bordeaux Metropole



## Si mund të përfshijë qyteti im sa më shumë grupe interesi në përballimin e sfidave të sistemit ushqimor?

**Bordeaux Metropole** u kujton qyteteve të tjera të investojnë kohë dhe energji në ndërtimin e marrëdhënieve me grupet e interesit

Politika ushqimore e një qyteti, ose veprimet e tjera për ushqimin, duhet të përfaqësojnë grupet e ndryshme të interesit për sistemin ushqimor të atij qyteti. Të gjitha qytetet e Food Trails kanë përjetuar rëndësinë e përfshirjes së llojeve të ndryshme të grupeve të interesit – anëtarët e stafit të bashkisë, prodhuesit në shkallë të vogël, fermerët agroekologjikë, bizneset vendore, autoritetet shëndetësore, grupet e konsumatorëve, sektori i tretë dhe organizatat bamirëse e më shumë. Këshilli ushqimor i Metropolit të Bordosë aktualisht ka mbi 300 anëtarë. Kjo gamë e gjerë mbështetjeje mundësoi që Metropoli të zhvillojë një politikë të fortë dhe ambicioze ushqimore dhe plane veprimi për një sistem të qëndrueshëm rajonal të ushqimit që mbron nevojat e prodhuesve, konsumatorëve dhe agromjedisin më të gjerë.



Bordeaux

Bordeaux Metropole ka 814 000 banorë në zonën e saj metropolitane, që përfshin 28 bashki. Bashkitë janë përgjegjëse për të siguruar ushqimin për shkollat dhe të moshuarit; në Bordeaux Metropole, prodhohen 65 000 vakte në ditë për shkollat dhe organizatat e tjera. Bordeaux Metropole nënshkroi MUFPP-in në vitin 2015 dhe krijoi këshillin e politikave ushqimore në vitin 2017. Gjatë Food Trails, Metropole zbatoi një politikë ushqimore të përbashkët dhe ambicioze që përfshin masa për të përmirësuar prokurimin e mensave për të pasur qasje në ushqim të shëndetshëm, të qëndrueshëm dhe lokal. Bordeaux Metropole gjithashtu punoi për të forcuar rrjetet lokale dhe vizionin e përbashkët të këshillit të tyre të politikave ushqimore.





### 3. Shembuj > 3.1 Qeverisja > Bordeaux Metropole



Falë punës së tij të mëparshme për krijimin e këshillit të vet për politikën ushqimore, Bordeaux Metropole ishte në gjendje të arrinte qëllimin e tij për të zhvilluar dhe zbatuar një politikë gjithëpërfshirëse ushqimore. Një seri seminaresh tematike i lejuan njerëzit të paraqitnin idetë e tyre se si të arrinin qëllimin e tyre të përbashkët. Përfaqësuesit e Metropolit zbuluan se ishte e vështirë të përfshinin disa grupe interesi të rëndësishme: shumë njerëz nuk i besonin pushtetit vendor dhe nuk ndiheshin të dëgjuar ose të përfaqësuar prej tyre. Kapërcimi i kësaj ndjenje mori kohë dhe shumë angazhime të përsëritura me grupet e interesit, duke bërë të mundur në fund që pikëpamjet dhe sugjerimet e njerëzve të përfshiheshin në zhvillimin e planeve rajonale të politikës ushqimore. Këshilli i politikës ushqimore i Metropolit tani është organi zyrtar drejtues për politikën ushqimore të Metropolit. Anëtarët punojnë së bashku sipas kompetencës së tyre primare, siç janë shërbimet publike, kultivimi ose përpunimi. Grupet e punës janë të organizuara rreth temave të tilla si zinxhirët ushqimorë, qasja e barabartë në ushqim cilësor të qëndrueshëm dhe ushqimi i mbetur. Bashkimi i individëve me kompetenca të ndryshme, por me shqetësime të përbashkëta, bën të mundur që këshilli të jetë reagues, demokratik dhe të ketë besimin e anëtarëve dhe të komunitetit. Ruajtja e dialogut dhe të qenët transparent për të gjitha veprimet dhe vendimet ndihmon që njerëzit ta mbështesin këshillin e politikës ushqimore dhe politikën ushqimore që ata kanë zhvilluar.







### 3. Shembuj > 3.1 Qeverisja > Bordeaux Metropole



Bordeaux Metropole ka hasur sfida në punën me këshillin e tyre të politikës ushqimore sa i përket politikës ushqimore dhe çështjeve të tjera. Sfida kryesore ishte balancimi i kohës për diskutim me veprime konkrete, pasi burimet njerëzore janë të kufizuara. Kultivimi dhe zhvillimi i marrëdhënieve për qeverisje gjithëpërfshirëse kërkon kohë. Dhe megjithëse këshilli ka përfaqësim të gjerë, ka grupe të rëndësishme interesi në sistemin vendor agro-ushqimor, siç është vreshtaria, që nuk janë shumë të përfshirë. Puna e këshillit të politikës ushqimore të Metropolit nxitet nga dinamizmi dhe entuziazmi i grupeve vendore të interesit që punojnë së bashku për objektiva të përbashkëta. Mbahen seminare me grupet kryesore të interesit që punojnë së bashku për të realizuar planin e veprimit për politikën ushqimore të Metropolit.



**Përdorni përvojat e të tjerëve si frymëzim për aktivitetet e ardhshme. Edhe nëse burimet dhe koha aktualisht janë të pamjaftueshme për t'i zbatuar, këto ide mund të ruhen derisa të ndryshojnë kushtet.**



3. Shembuj > 3.1 Qeverisja > **Birmingami**

## Si mund të sigurohet qyteti im që politika jonë ushqimore të jetë e lidhur me kontekstin e saj më të gjerë politik dhe ekonomik?

Strategjia e sistemit ushqimor të **Birmingamit** pasqyron pikat e forta dhe sfidat sociale, kulturore dhe ekonomike të qytetit

Politikat për ushqimin janë më efektive nëse zhvillohen me mbështetjen e politikanëve nga të gjitha partitë politike, si dhe të grupeve vendore të interesit, siç janë OJQ-të, organizatat vullnetare, grupet e komunitetit dhe bizneset vendase. Ata gjithashtu duhet të njohin dhe të angazhohen me faktorët më të gjerë që ndikojnë në sistemin ushqimor të një qyteti, siç janë pabarazia socio-ekonomike, reklamimi i ushqimeve të pashëndetshme dhe mungesa e tokës. Birmingami është një qytet i madh, i larmishëm nga ana kulturore me shumë sfida ekonomike dhe të shëndetit publik. Qyteti punon vazhdimisht me qytetarët e tij në të gjitha nivelet për çështjet që lidhen me ushqimin: këshilli i qytetit ka lidhje të forta me bizneset, shërbimet publike dhe grupet e komunitetit.



Birmingami është një qytet shumë i larmishëm nga ana kulturore me 1,2 milionë banorë. Qyteti është anëtar i komitetit drejtues të Paktit të Politikës Ushqimore Urbane të Milanos dhe miratoi Strategjinë e vet të Sistemit Ushqimor në vitin 2022. Në të kaluarën, Birmingami ishte pjesë e një programi mbarëkombëtar për të luftuar obezitetin te fëmijët. Veprimet e tyre pilot përqendrohen në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për luftën kundër shpërdorimit të ushqimit, promovimin e prodhimit vendas të ushqimit për sigurinë ushqimore dhe inkurajimin e të rinjve për të ngrënë një dietë të shëndetshme që përfshin fasule dhe bishtajore.



### 3. Shembuj > 3.1 Qeverisja > Birminghami



Përmes një sërë eventesh për sensibilizimin e publikut gjatë zhvillimit të strategjisë së tyre të sistemit ushqimor, zyrtarët e qytetit kuptuan rëndësinë e përfshirjes së veprimeve të lidhura me ushqimin në kontekstin më të gjerë politik dhe ekonomik që ndikon në mundësinë e banorëve të qytetit për të pasur qasje në ushqim të shëndetshëm. Kjo çoi në një strategji ku ushqimi pozicionohet brenda objektivave më të gjera të projektuara për të rigjallëruar ekonominë dhe mjedisin fizik. Birminghami e zhvilloi Strategjinë e Sistemit Ushqimor në partneritet me bizneset, aktivistët, qytetarët, zyrtarët e shëndetit publik dhe të tjerë. Strategjia e tyre thekson nevojën për një sistem ushqimor rigjenerues që njeh dhe heq pengesat dhe praktikatat e paqëndrueshme që dëmtojnë mjedisin, komunitetet dhe ekonominë. Projektet për të përballuar këto sfida zhvillohen në nivele të shumfishta: organizatat vendase të komunitetit që luftojnë varfërinë, partneritetet kërkimore që punojnë për shëndetin publik dhe planetar dhe partneritetet ndërkombëtare, të tilla si Food Trails dhe Pakti i Politikës Urbane Ushqimore të Milanos (MUFPP), të cilët i mbështesin qytetet në shkëmbimin e praktikave më të mira dhe njohjen e faktorëve kulturorë që nxisin praktikatat ushqimore. Birminghami ka zhvilluar një mjet për Vendimmarrjen dhe Prioritizimin e Veprimeve për Ushqimin (FADMaP), i cili lejon që t'u japë përparësi veprimeve që mbështeten nga qytetarët, të promovojë diversitetin e qytetit dhe të luftojë varfërinë dhe pabarazitë.





### 3. Shembuj > 3.1 Qeverisja > **Birminghami**



Për më tepër, qyteti promovon një ekonomi ushqimore rrethore që mbështet bizneset e vogla dhe e konsideron ushqimin e mbetur si një burim të vlefshëm që mund të rigjallërojë tokat e varfra dhe të mbështesë prodhimin vendas të ushqimit.

Strategjia e Sistemit Ushqimor të Birminghamit është ambicioze dhe pasqyron përvojën, njohuritë dhe pikëpamjet e banorëve të qytetit. Duke u angazhuar në mënyrë aktive me individë dhe organizata që më parë ndiheshin të lënë jashtë proceseve politike, strategjia i bashkoi njerëzit dhe ka mbështetje të gjerë. Një përfitim i papritur nga ky proces gjithëpërfshirës ishte një besim dhe energji e përtërirë në qeverisjen me pjesëmarrje. Kjo ka qenë edhe përvoja e Bordeaux Metropole, në punën e tyre për zhvillimin e një këshilli gjithëpërfshirës të politikës ushqimore dhe të politikës ushqimore.



**Strategjia e Sistemit  
Ushqimor të Birminghamit  
njuh pengesat dhe praktikat e  
paqëndrueshme që dëmtojnë  
mjedisin, komunitetet dhe  
ekonominë.**







3. Shembuj > 3.1 Qeverisja > Selaniku



## Si mund t'i bëjë qyteti im të punojnë së bashku përfaqësuesit nga departamentet e shumta bashkiake dhe organizatat e jashtme?

**Selaniku** bashkëprojektoi politikën e tij ushqimore përmes seminareve pjesëmarrëse me departamente të ndryshme bashkiake dhe grupe të jashtme interesi

Qytetet e Food Trails ishin në faza shumë të ndryshme të udhëtimit të tyre në zhvillimin e politikave dhe veprimeve të lidhura me ushqimin. Një nga qëllimet kryesore për disa qytete ishte zhvillimi i një këshilli ushqimor, i cili më pas do të zhvillonte një politikë ushqimore për qytetin. Kështu ishte edhe Selaniku.

Selaniku tashmë kishte vënë në zbatim disa masa që mbështesnin përpjekjet e tyre për të zhvilluar një këshill ushqimor dhe politikë ushqimore. Ai është një qytet i gastronomisë i UNESCO-s dhe ka rrjete me grupe interesi. Gjithashtu ka punuar në nismat Net Zero, dhe disa departamente bashkiake po punojnë për ushqimin e mbetur.



Selaniku, me 300.000 banorë dhe mbi 1 milion në zonën e tij metropolitane, është një qytet port me një trashëgimi të larmishme multikulturore. Me krenari bën pjesë në rrjetin e Qyteteve të Gastronomisë të UNESCO-s dhe organizon një festival vjetor të ushqimit. Selaniku ka qenë nënshkrues i Paktit të Politikës Urbane Ushqimore të Milanos (MUFPP) që nga fillimi i tij në vitin 2015 dhe ka zhvilluar Strategjinë e Selanikut 2030 për aftësinë rikuperuese vendase. Masat e tyre pilot përqendrohen në krijimin e një rrjeti mbështetës vendor me grupe interesi dhe të aktivitete të bujqësisë urbane.



### 3. Shembuj > 3.1 Qeverisja > Selaniku



Laboratorët e novacionit të qytetit mbledhën së bashku grupe të ndryshme interesi nga organizata të lidhura me ushqimin, përfaqësues të qeverisë dhe OJQ-të. U përfshinë departamente të ndryshme të bashkisë, përfshirë ato që mbikëqyrin zhvillimin ekonomik, turizmin, hapësirat e gjelbra, çështjet sociale dhe më shumë. Këshilli vuri në dukje në mënyrë specifike rëndësinë e përfshirjes së grupeve të cenueshme që shpesh anashkalohe në qeverisje. Kjo është e rëndësishme, pasi qytete të tjera kanë vënë re se qeverisja lokale dhe rajonale ka përfitime të mëtejshme duke zhvilluar sisteme pjesëmarrëse që inkurajojnë pjesëmarrjen e një gamë të gjerë individësh. Pastaj Selaniku bashkëprojektoi politikën e tij ushqimore përmes një sërë seminaresh pjesëmarrëse, duke u përqendruar në temat që lidhen me fushat kryesore të MUFPP-së. Kjo i dha strukturë procesit të pjesëmarrjes. Qyteti ka punuar me MamaGaia-n, një organizatë mjedisore me përvojë në hartimin e proceseve pjesëmarrëse për nismat sociale dhe mjedisore.

Selaniku ka kuptuar rëndësinë e përfshirjes së departamenteve të ndryshme bashkiake në këshillin e tyre ushqimor dhe zhvillimin e politikës, por gjithashtu ata kanë vënë re se ndonjëherë është më e lehtë të komunikosh me partnerë të jashtëm sesa me departamentet e brendshme bashkiake, për shkak të modeleve të izoluara të punës në qeverisjen vendore.







### 3. Shembuj > 3.1 Qeverisja > Selaniku



Kapërcimi i këtij lloji të stilit të qeverisjes ka qenë një sfidë e zakonshme për shumicën e qyteteve të Food Trails. Selaniku gjithashtu hasi një hendek midis zhvillimit të një politike dhe zbatimit të veprimeve të rekomanduara, për shkak të mungesës së një kuptimi dhe angazhimi më të gjerë për këtë lloj pune, e cila është shumë e re në Greqi. Ky është një problem që e përjetuan shumë qytete të Food Trails dhe një mësim i rëndësishëm për të gjitha qytetet: zhvillimi i një këshilli ushqimor dhe politike ushqimore është pjesë e udhëtimit të transformimit të sistemit ushqimor urban – por nuk është destinacioni përfundimtar!



Zhvillimi i një këshilli ushqimor dhe politike ushqimore është pjesë e udhëtimit të transformimit të sistemit ushqimor urban – por nuk është destinacioni përfundimtar!





## 3.2 USHQIMI I MBETUR

Bashkitë mund të mbështesin hapësirat publike të ngrënies dhe furnizuesit e tyre me shumicë mund të ndihmojnë për monitorimin dhe pakësimin e ushqimit të mbetur.

Përpjekjet në mbarë qytetin mund të përfshijnë edukimin publik dhe mundësitë për krijimin dhe përdorimin e ushqimit të mbetur të kthyer në pleh, si dhe garantimin që legjislacioni dhe udhëzimet për përdorimin e ushqimit të mos nxitin mbetje të panevojshme të ushqimit.

Qytetet e Food Trails kanë trajtuar disa nga pyetjet e mëposhtme për ushqimin e mbetur:

1

Qyteti im ka legjislacion dhe rregullore kufizuese për trajtimin e ushqimit të mbetur që rrisin sasinë e ushqimit të mbetur në industrinë e shërbimit të ushqimit. Çfarë duhet të bëjmë?  
Varshavë

2

Si mund të jetë qyteti im më efikas në rishpërndarjen e tepricës së ushqimit, në mënyrë që të mos shpërdorohet dhe të shkojë te njerëzit në nevojë?  
Milano

3

Si mund të mbështesë qyteti im zhvillimin e njohurive dhe aftësive të qytetarëve në lidhje me ushqimin e mbetur, ruajtjen e ushqimit dhe shndërrimin në pleh?  
Birmingami



3. Shembuj > 3.2 Ushqimi i mbetur > Varshava



## Qyteti im ka legjislacion dhe rregullore kufizuese për trajtimin e ushqimit të mbetur që rrisin sasinë e ushqimit të mbetur në industrinë e shërbimit të ushqimit. Çfarë duhet të bëjmë?

**Varshava** punoi me avokatë dhe përfaqësues të industrisë për të përmirësuar njohjen e legjislacionit përkatës

Përvojat e qyteteve dhe hulumtimet akademike konfirmojnë se një nxitës kryesor i ushqimit të mbetur është legjislacioni shpesh konfuz rreth trajtimit dhe rishpërndarjes së ushqimit. Edukimi i konsumatorëve për termat 'data e skadimit' dhe 'të përdoret para datës' është një nga përpjekjet që është ndërmarrë në këtë drejtim. Udhëzimet dhe legjislacioni mund të jenë veçanërisht sfidues për bizneset që mund të jenë në rrezik të ndëshkimeve ligjore për mostrajtimin e duhur të ushqimit. Kjo është një çështje veçanërisht serioze për hotelet, restorantet dhe bizneset e shërbimit të ushqimit, të cilët gjenerojnë një nivel të lartë ushqimi të mbetur, por shpesh anashkalohen në kërkimet dhe ndërhyrjet për pakësimin e ushqimit të mbetur.



Varshava ka pothuajse 1,8 milion banorë, nga të cilët më shumë se 220 000 janë studentë. Është njohur si një qytet kryesor evropian për mbështetjen e zhvillimit të biznesit. Ajo krenohet me një industri të rëndësishme të agrobiznesit me aktivitete të forta bujqësore periurbane, të realizuara me mbështetjen e njësive kërkimore të agrobiznesit. Nismat e tyre pilot synojnë zhvillimin e një sistemi efikas të dhurimit dhe shpërndarjes së ushqimit, duke theksuar bashkëpunimin me bizneset lokale për të nxitur një sistem të qëndrueshëm ushqimor.




### 3. Shembuj > 3.2 Ushqimi i mbetur > Varshava



Nëpërmjet Food Trails, Varshava zhvilloi një Laborator Ushqimi i cili ka punuar për pakësimin e ushqimit të mbetur në restorante. Laboratori i Ushqimit është një koalicion akademikësh, avokatësh të ushqimit, pronarësh restorantesh dhe stafit të tyre, të cilët punojnë së bashku për pakësimin e ushqimit të mbetur në të gjitha fazat në bizneset ushqimore. Shpejt u bë e qartë se të gjitha bizneset ushqimore në qytet kishin frikë të merrnin pjesë në skemat e rishpërndarjes së tepricës ushqimore për shkak të frikës së tyre nga shkelja e ligjeve në lidhje me trajtimin e duhur të ushqimit ose ligjet tatimore rreth dhurimeve. Kjo gjithashtu theksoi faktin se shpërdorimi i ushqimit në këto biznese vërehet në shumë faza: në kuzhina, para dhe pas shërbimit të ushqimit klientëve.

Dhurimi i ushqimit pas "datës së skadimit" lejohet në Bashkimin Evropian, për sa kohë që produkti është ende i sigurt dhe i ngrënshëm. Vende të ndryshme kanë legjislacionin e tyre kombëtar që mbështet ose kufizon këtë rishpërndarje të ushqimit të tepërt për individë ose organizata bamirësie. Ata kanë vërejtur se institucione të ndryshme të kontrollit të ushqimit mundën dhe nxjerrin interpretimet e tyre të rregulloreve për sigurinë ushqimore. Kjo shkakton konfuzion në mesin e bizneseve që kanë frikë të bëjnë gabime dhe të thyejnë ligjet.





### 3. Shembuj > 3.2 Ushqimi i mbetur > Varshava



Avokatët e ushqimit janë bërë aleatë të rëndësishëm të Laboratorit të Ushqimit të Varshavës. Ata rekomandojnë udhëzime të qarta dhe të thjeshta për bizneset dhe për zhvillimin e legjislacionit kombëtar që mbështet dhe inkurajon rishpërndarjen e ushqimit të tepërt. Spanja po zhvillon qasje inovative për të trajtuar këtë problem, siç është kërkesa që restorantet të ofrojnë enë për klientët që dëshirojnë të marrin në shtëpi pjesë të pangrëna të vaktit të tyre.

Kuptimi më i mirë i kornizave ligjore dhe zhvillimi i ligjeve e praktikave - si dhe mbështetja kulturore dhe e biznesit për rishpërndarjen e tepcës ushqimore, të gjitha dotë ndihmojnë në pakësimin e ushqimit të mbetur.



**Ata rekomandojnë udhëzime të qarta dhe të thjeshta për bizneset për trajtimin e ushqimit të mbetur që mbështetin dhe inkurajojnë rishpërndarjen e ushqimit të tepërt.**





3. Shembuj > 3.2 Ushqimi i mbetur > Milano



## Si mund të jetë qyteti im më efikas në rishpërndarjen e tepricës së ushqimit, në mënyrë që të mos shpërdorohet dhe të shkojë te njerëzit në nevojë?

**Milano** përmirësoi logjistikën, infrastrukturën dhe partneritetet me grupet e interesit për një rishpërndarje më efikase

Shumë qytete në projektin Food Trails po punojnë për të pakësuar ushqimin e mbetur, pjesa më e madhe e të cilit është ende e përshtatshme për konsum njerëzor. Milano, si qytetet e tjera të Food Trails, po punon për grumbullimin e këtij ushqimi dhe përmirësimin e shpërndarjes së tij. Gjatë pandemisë Covid-19, Milano bëri një hartë gjithëpërfshirëse të organizatave vullnetare të qytetit që i mbështetnin komunitetet duke shpërndarë ushqimin e tepërt, si dhe duke siguruar infrastrukturën fizike që ishte e nevojshme për takryer të këtyre punëve. Kjo i siguroi bashkisë prova kyçe se si tepricat e ushqimit tashmë po rishpërndaheshin në mënyrë efektive në qytet.



Milano, me 1,4 milionë banorë dhe 3,5 milionë në zonën e saj metropolitane, shërben si kryeqyteti ekonomik dhe financiar i Italisë. Qyteti ka 8 universitete me gati 200 000 studentë. Në vitin 2014, Milano krijoi politikën e vet të ushqimit, duke përfshirë krijimin e 10 "Qendrave për reduktimin ushqimit të mbetur". Masat pilot të Milanos përqendrohen në përmirësimin e qarkullimit të sistemeve të mensave të shkollave në bashki, duke ndërhyrë në prokurimin publik dhe reduktimin e mbetjeve.





### 3. Shembuj > 3.2 Ushqimi i mbetur > Milano



Milano e pranon se ushqimi i mbetur vërehet në të gjitha fazat e sistemit ushqimor. Gjatë Covid-19, qyteti zhvilloi një koalicion të fuqishëm të sektorit privat, bankave ushqimore dhe organizatave jofitimprurëse. Koalicioni krijoi qendra me ushqim të mbetur në të gjithë qytetin: ushqimi që është ende i përshtatshëm për konsum njerëzor mblidhet nga supermarketet dhe mensat dhe dërgohet në qendra. Më pas, ky ushqim rishpërndahet përmes kuzhinave të supave, pakove ushqimore dhe dyqaneve të solidaritetit social, ku familjet mund të kenë qasje në ushqim të përbalueshëm që dhurohet nga burime të ndryshme. Milano ka zhvilluar gjithashtu një qendër grumbullimi në tregjet e saj kryesore të shitjes me shumicë të frutave dhe perimeve. Një hapësirë është vënë në dispozicion për organizata të ndryshme jofitimprurëse për të mbledhur tepricën e pashitur në fund të çdo dite tregtare. Milano e përfshin rishpërndarjen e tepricës ushqimore në kuadër të përpjekjeve më të gjera për të trajtuar pengesat e qytetarëve për një dietë të shëndetshme.

Hartimi dhe puna e Milanos për ushqimin e mbetur dhe tepricat e ushqimit e ka mësuar qytetin për rëndësinë e bashkëpunimit me aktorë të ndryshëm të sektorit privat, publik dhe vullnetar në të gjithë sistemin ushqimor. Infrastruktura, hapësira e magazinimit, transporti dhe barrierat logjistike duhet të merren parasysh kur qytetet zhvillojnë strategjinë e tyre për të pakësuar ushqimin e mbetur duke përmirësuar rishpërndarjen e tepricës ushqimore.






### 3. Shembuj > 3.2 Ushqimi i mbetur > Milano



Milano është gjithashtu e vetëdijshme se përmirësimi i rishpërndarjes së tepricës ushqimore nuk zgjidh varfërinë ushqimore dhe duhet të konsiderohet një çështje më vete. Ndihma ushqimore duhet të konsiderohet dhe të zhvillohet në një kontekst më të gjerë socio-ekonomik.



Infrastruktura, hapësira e magazinimit, transporti dhe barrierat logjistike ndikojnë në kapacitetin e qyteteve për të rishpërndarë tepricën e ushqimit.





## 3. Shembuj &gt; 3.2 Ushqimi i mbetur &gt; Birminghami



## Si mund të mbështesë qyteti im zhvillimin e njohurive dhe aftësive të qytetarëve në lidhje me ushqimin e mbetur, ruajtjen e ushqimit dhe shndërrimin në pleh?

Mbrojtësit e Komunitetit të **Birminghamit** ndryshuan idetë dhe sjelljet e njerëzve rreth ushqimit të mbetur

Shumë nisma për ushqimin e mbetur përqendrohen në pakësimin e mbetjeve dhe përdorimin më efikas të burimeve ushqimore. Megjithatë, disa pjesë të ushqimit, të tilla si lëkura e patates dhe lëvozhgat e vezëve, janë shumë të vështira për t'u përdorur. Është e rëndësishme që njerëzit dhe organizatat të gjejnë mënyra për t'i përpunuar në mënyrë efikase këto mbetje. Shndërrimi në pleh mund të ndihmojë për të pakësuar mbetjet ushqimore, si dhe për të krijuar pleh organik të vlefshëm për kultivimin e ushqimit. Kjo kontribuon në një ekonomi rrethore, e cila është një nga qëllimet e Food 2030. Birminghami ka goxha eksperiencë në punën me nismat e komunitetit dhe i ka përdorur këto marrëdhënie për të promovuar shndërrimin në pleh dhe edukimin për ushqimin e mbetur në të gjithë komunitetin.



Birminghami është një qytet shumë i larmishëm nga ana kulturore me 1,2 milionë banorë. Qyteti është anëtar i komitetit drejtues të Paktit të Politikës Ushqimore Urbane të Milanos dhe miratoi Strategjinë e vet të Sistemit Ushqimor në vitin 2022. Në të kaluarën, Birminghami ishte pjesë e një programi mbarëkombëtar për të luftuar obezitetin te fëmijët. Veprimet e tyre pilot përqendrohen në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për luftën kundër shpërdorimit të ushqimit, promovimin e prodhimit vendas të ushqimit për sigurinë ushqimore dhe inkurajimin e të rinjve për të ngrënë një dietë të shëndetshme që përfshin fasule dhe bishtajore.



### 3. Shembuj > 3.2 Ushqimi i mbetur > Birminghami



Një nga laboratorët e novacionit të Birminghamit u përqendrua në punën me grupet e komunitetit vendas për të pakësuar ushqimin e mbetur dhe për të rritur njohuritë, aftësitë dhe motivimin rreth shndërrimit në pleh. Birminghami i lidhi objektivat e tij të dëshiruara finale e afatgjata me hapat përkatës paraprakë dhe rezultatet e pritshme të veprimeve e të ndërhyrjeve në faza të ndryshme të laboratorit të novacionit. Qyteti punoi ngushtë me grupet e komunitetit të cilët tashmë kishin marrëdhënie të forta pune me lagjen ku ishte planifikuar testimi pilot. Projekti synonte të ndryshonte sjelljet rreth ushqimit të mbetur dhe që njerëzit të ndanin ushqimin e mbetur nga mbeturinat në përgjithësi. Ai synonte tre lloje të ndryshme strehimi, me shkallë të ndryshme qasjeje në kopshte ose hapësira publike për përpunimin e plehut. Projekti vuri në dukje se banorët kanë nevojë për infrastrukturë të gjelbër – kontejnerë për përpunimin e plehut dhe materiale për fermentimin e bokashit ose vermikompostimin (përpunimin e plehut me krimba) – dhe infrastrukturë sociale – banorë të lagjes që ishin entuziastë e të përkushtuar ndaj projektit dhe të gatshëm për të promovuar qëllimet e tij e për t'i ndarë njohuritë praktike dhe entuziazmin e tyre me fqinjët e tyre. Këta 'Mbrotjtës të Komunitetit' promovuan gjithashtu përdorimin e plehut në skemat e kultivimit të bimëve të komunitetit.







### 3. Shembuj > 3.2 Ushqimi i mbetur > Birminghami



Ashtu si shumë nga nismat e Birminghamit për ushqimin, projekti i tyre i kthimit në pleh të mbetjeve ushqimore është zhvilluar dhe realizuar me komunitetin lokal. Ai gjithashtu ka përfshirë objektiva më të gjera të sistemit ushqimor, të tilla si promovimi i një diete të shëndetshme dhe inkurajimi i kultivimit urban të frutave dhe perimeve. Projekti u përqendrua gjithashtu në komunitetet 'e dëgjuaara rrallë', të cilat hasin pengesa sociale dhe ekonomike për një dietë të shëndetshme.



'Sipas përvojës së Birminghamit, programet e realizuara 'për' komunitetin dhe jo 'me' ndihmën e komunitetit kanë pak shanse të shkaktojnë ndryshime afatgjata të sjelljes.'



3. Shembuj > 3.3 Prodhimi i ushqimit



## 3.3 PRODHIMI I USHQIMIT

Qytetet mund të përforcojnë prodhimin e qëndrueshëm të ushqimit duke promovuar lidhjet rurale-urbane, duke përdorur një qasje të ekosistemit për të udhëhequr planifikimin dhe menaxhimin e përdorimit të tokës, duke garantuar qasje të

sigurt te toka për prodhim të qëndrueshëm të ushqimit, si dhe duke siguruar mbështetje materiale dhe logjistike për prodhuesit ushqimorë urbanë dhe periurbanë.



Qytetet e Food Trails kanë trajtuar pyetjet e mëposhtme rreth prodhimit të ushqimit:

1

Duam të sigurohemi që njerëzit të mund të kultivojnë më shumë ushqim në qytetin tonë. Çfarë mund të bëjmë?  
Bergamo

2

Si mund t'i mbështesë qyteti im prodhuesit që përdorin metoda agroekologjike për prodhimin e ushqimit?  
Bordeaux Metropole

3

Si mund të forcojë qyteti im lidhjet midis prodhuesve dhe konsumatorëve?  
Grenoble Alpes Metropole





## 3. Shembuj &gt; 3.3 Prodhimi i ushqimit &gt; Bergamo



## Duam të sigurohemi që njerëzit të mund të kultivojnë më shumë ushqim në qytetin tonë. Çfarë mund të bëjmë?

Toka urbane dhe periurbane në pronësi të komunës së **Bergamos** përdoret nga grupet e komunitetit për prodhimin e ushqimit

Prodhimi i ushqimit në qytete është një reagim i zakonshëm për të garantuar sigurinë ushqimore urbane. Është e rëndësishme të garantohet që toka në dispozicion të mbrohet për prodhimin e ushqimit dhe që individët dhe komunitetet në nevojë të kenë qasje te toka për prodhimin e ushqimit. Si pjesë e punës së vet në Food Trails, Bergamo ka hartëzuar hapësirat urbane dhe peri-urbane në rritje dhe ka siguruar që përfitimi i këtyre hapësirave në rritje të mbështesë komunitetet që përballen me sfida të shumta.

Bergamo mblodhi të dhëna të rëndësishme se nga vinte ushqimi i qytetit, çfarë toke disponohej brenda dhe afër qytetit dhe se si toka komunale mund të përdorej më së miri për prodhimin e ushqimit.



Bergamo ka 121 000 banorë, duke përfshirë mbi 23 000 studentë. U emërua qytet kreativ i gastronomisë nga UNESCO në vitin 2019. Qyteti ka një këshill aktiv të politikave ushqimore dhe ka organizuar festivalin "Bujqësia dhe e drejta për ushqim" që nga viti 2017. Masat e tyre pilot adresojnë edukimin ushqimor, qëndrueshmërinë e sistemit të mensës së shkollës dhe prokurimin.





### 3. Shembuj > 3.3 Prodhimi i ushqimit > Bergamo



Qyteti ka rregullore të reja se kush mund ta përdorë tokën komunale për kopshtari urbane. Kjo për të shmangur problemin e zakonshëm të përdorimit të tokës publike për përfitime private. Në Bergamo, toka urbane për prodhimin e ushqimit u jepet me përparësi familjeve me fëmijë të vegjël dhe organizatave që punojnë për të promovuar përfitimet sociale dhe ekonomike. Parcelat janë zvogëluar në madhësi dhe u caktohen individëve për tri vjet, periudhë pas së cilës qiraja mund të rinovohet. E gjithë toka duhet të kultivohet në mënyrë organike për të siguruar një mjedis të shëndetshëm në kopshte dhe zonën përreth që ka popullsi të dendur. Këto kopshte ofrojnë edukim për qiramarrësit për rritjen e frutave dhe perimeve në mënyrë organike. Bergamo po promovon edhe rritjen e pemëve frutore në të gjithë qytetin. Kopshtet botanike të qytetit janë të angazhuara për promovimin e agrobiodiversitetit territorial. Ai po zgjeron programet arsimore për të mbështetur kultivimin e kulturave ushqimore të përshtatshme dhe të ripërtërishme në qytet dhe në rajonin përreth. Provinca përreth Bergamos ka shumë aktivitete bujqësore organike. Qyteti po promovon mundësi biznesi në bujqësinë organike për të rinjtë, si dhe po promovon dhe mbështet bashkëpunimet hortikulturore midis kultivuesve organikë dhe nismave të tjera sociale.







### 3. Shembuj > 3.3 Prodhimi i ushqimit > Bergamo



Hartëzimi i plotë i sistemit të tij ushqimor urban dhe rajonal mbështeti planet e Bergamos për të promovuar prodhimin e qëndrueshëm të ushqimit, për të zgjeruar qasjen në hapësirat urbane dhe peri-urbane në rritje dhe për të zhvilluar mbështetje materiale dhe logjistike për prodhuesit. Ky proces hartëzimi i ka siguruar qytetit të dhëna të rëndësishme mbi statusin aktual të sistemit të tij ushqimor, aktorët kryesorë të përfshirë dhe atë që qyteti duhet t'i japë përparësi për të rritur qëndrueshmërinë e sistemit ushqimor.



**Në Bergamo, toka urbane për prodhimin e ushqimit u jepet me përparësi familjeve me fëmijë të vegjël dhe organizatave që punojnë për të promovuar përfitimet sociale dhe ekonomike.**



## 3. Shembuj &gt; 3.3 Prodhimi i ushqimit &gt; Bordeaux Metropole



## Si mund t'i mbështesë qyteti im prodhuesit drejt përdorimit të më shumë metodave agro-ekologjike për prodhimin e ushqimit?

**Bordeaux Metropole** ofron mbështetje teknike dhe financiare për prodhuesit për t'i lejuar ata të përdorin më shumë praktika agroekologjike dhe i mbështet në zhvillimin e mundësive të tregut vendas dhe fitimprurës

Me mbështetjen e Food Trails, Bordeaux Metropole kreu një analizë të hollësishme të sistemit të vet ushqimor territorial, duke rezultuar në një strategji të plotë dhe ambicioze të qëndrueshmërisë bujqësore dhe ushqimore. Metropole pranon se arritja e statusit të plotë dhe të certifikuar organik mund të duket sfiduese për shumë prodhues. Prandaj synon 100% prodhim agroekologjik, me 30% prodhim organik të certifikuar deri në vitin 2027 dhe 50% deri në vitin 2050. Këta janë objektiva ambiciozë politikë që kërkojnë masa të rëndësishme teknike dhe praktike për t'u zbatuar.



Bordeaux

Bordeaux Metropole ka 814 000 banorë në zonën e saj metropolitane, që përfshin 28 bashki. Bashkitë janë përgjegjëse për të siguruar ushqimin për shkollat dhe të moshuarit; në Bordeaux Metropole, prodhohen 65 000 vakte në ditë për shkollat dhe organizatat e tjera. Bordeaux Metropole nënshkroi MUFPP-in në vitin 2015 dhe krijoi këshillin e politikave ushqimore në vitin 2017. Gjatë Food Trails, Metropole zbatoi një politikë ushqimore të përbashkët dhe ambicioze që përfshin masa për të përmirësuar prokurimin e mensave për të pasur qasje në ushqim të shëndetshëm, të qëndrueshëm dhe lokal. Bordeaux Metropole gjithashtu punoi për të forcuar rrjetet lokale dhe vizionin e përbashkët të këshillit të tyre të politikave ushqimore.






### 3. Shembuj > 3.3 Prodhimi i ushqimit > Bordeaux Metropole



Këtu përfshihet ofrimi i trajnimeve për pjesëmarrësit e rinj në sektorin e bujqësisë, qasjen në tokë dhe mundësitë e tregut për prodhuesit agroekologjikë që u lejojnë të fitojnë një çmim të drejtë për produktin e tyre.

Prodhuesit agroekologjikë përballen me sfida të mëdha ekonomike, pasi është një metodë më e shtrenjtë, më intensive e punës për prodhimin e ushqimit. Qasja në tregje të besueshme për prodhimet e tyre, së bashku me rritjen e kostove të prodhimit, mund të krijojnë pengesa dërrmuese si për prodhuesit e rinj agroekologjikë, ashtu edhe për ata të vjetër. Bordeaux Metropole e ka bërë zhvillimin e tregjeve të besueshme për këta prodhues një qëllim kryesor në ambiciet e tij territoriale të sistemit ushqimor. Ai ka krijuar partneritete të forta me prodhuesit vendas të ushqimit dhe vazhdimisht i qaset të gjitha masave për ushqimin brenda kontekstit të një strategjie rajonale të ushqimit që balancon nevojën e konsumatorëve për ushqim të shëndetshëm me nevojën e prodhuesve për një çmim të drejtë. Fermerët kanë një zë të fortë në këshillin ushqimor. Metropole mbështet nismat vendore që blejnë ushqime drejtpërdrejt nga prodhuesit vendas, duke siguruar një çmim të drejtë dhe një treg të besueshëm për kultivuesit agroekologjikë.







### 3. Shembuj > 3.3 Prodhimi i ushqimit > Bordeaux Metropole



Ata gjithashtu punojnë me zyrtarët e tyre të prokurimit për t'i ndihmuar të rrisin sasinë e ushqimit të prodhuar në vend që përdoret brenda sistemit të tij kolektiv të hotelerisë dhe të sigurojnë investime financiare për fermerët që kanë nevojë për mbështetje në ndryshimin e praktikave të tyre të prodhimit të ushqimit në metoda agroekologjike. Metropole gjithashtu koordinon një grup ekspertësh për të lehtësuar hyrjet e reja në bujqësi, veçanërisht ato që përdorin praktika agroekologjike.



**Dhënia e një zëri të fortë  
fermerëve në këshillin  
ushqimor ndihmon në  
zbatimin e masave përkatëse  
për transformimin e sistemit  
ushqimor lokal.**



3. Shembuj > 3.3 Prodhimi i ushqimit >  
Grenoble Alpes Metropole



## Si mund të forcojë qyteti im lidhjet midis prodhuesve dhe konsumatorëve?

**Grenoble Alpes Metropole** organizon ngjarje dhe aktivitete që lidhin prodhuesit me konsumatorët

Forcimi i lidhjeve rurale-urbane dhe lidhja e drejtpërdrejtë e prodhuesve dhe konsumatorëve është një hap i rëndësishëm në sigurimin e prodhimit të qëndrueshëm të ushqimit. Shumë qytete të Food Trails kanë punuar në zhvillimin e sistemeve ushqimore territoriale ose rajonale. Grenoble Alpes Metropole zhvilloi muajin e tranzicionit të ushqimit për të siguruar edukim dhe frymëzim në lidhje me prodhimin e ushqimit dhe për të forcuar lidhjet midis prodhuesve dhe konsumatorëve.



Grenoble Alpes Metropole ka 480 000 banorë dhe 65 000 studentë, të shpërndarë në 49 bashki. I njohur si Kryeqyteti i Gjelbër Evropian në vitin 2022, Metropole kontribuon në nxitjen e një sistemi të qëndrueshëm ushqimor si anëtar i Paktit të Politikës Urbane të Ushqimit në Milano. Që nga viti 2020, Metropole organizon një muaj të tranzicionit të ushqimit për të rritur ndërgjegjësimin te qytetarët. Masat e tjera pilot gjatë Food Trails po promovojnë një tranzicion të qëndrueshëm në mensat e shkollës dhe zhvillimin e një këshilli ndërterritorial të ushqimit me bashkitë e tij.



### 3. Shembuj > 3.3 Prodhimi i ushqimit > Grenoble Alpes Metropole



Muaji i tranzicionit ushqimor u hartua për të rritur ndërgjegjësimin për rolin qendror të ushqimit në një tranzicion ekologjik dhe rëndësinë e prodhuesve vendas agroekologjikë. Gjatë një muaji, Metropole organizoi shfaqje gatimi, debate, bisedime, ushqime të përbashkëta, vizita në fermë, tregje fermerësh dhe më shumë.

Këto aktivitete shfaqën rëndësinë e prodhuesve vendorë dhe krijuan mundësi për konsumatorët për të parë dhe për të shijuar ushqimin e prodhuar në vend. Në ngjarje u trajtuan edhe disa nga elementet më sfiduese të prodhimit të ushqimit, të tilla si garantimi që ushqimi i shëndetshëm të jetë i përbalueshëm për konsumatorët dhe roli i qeverisjes vendore në mbështetjen e prodhuesve agroekologjikë. U mbajtën bisedime dhe debate publike në lidhje me të ardhmen e prodhimit të ushqimit në Metropole, ndryshimet klimatike, solidaritetin për ushqimin, ndikimin e bujqësisë industriale dhe uljen e ushqimit të mbetur. Gjatë gjithë bisedimeve dhe ngjarjeve, u theksua lidhja e prodhuesve ruralë dhe konsumatorëve urbanë.





### 3. Shembuj > 3.3 Prodhimi i ushqimit > Grenoble Alpes Metropole



Ndërsa muaji i tranzicionit të ushqimit përfshinte një gamë mbresëlënëse dhe një sërë ngjarjesh, është e rëndësishme që qytetet që kërkojnë të organizojnë ngjarje të ngjashme të marrin parasysh mënyrat e monitorimit të ndikimit të ngjarjeve publike. Qytetet shpesh vlerësojnë numrin e të pranishmëve, por kjo jo gjithmonë jep informacion rreth ndikimit të këtyre ngjarjeve në ndryshimin e sjelljeve ose në rritjen e ndërgjegjësimit. Është gjithashtu e rëndësishme të sigurohet që ngjarje të tilla të përfshijnë audienca të reja të cilat mund të mos jenë të njohura me çështjet ose mund të jenë më pak të prirura për të marrë pjesë.



**Muaji i tranzicionit të ushqimit të Grenoble Alpes Metropole përfshin demonstrime gatimi, debate, bisedime, ushqime të përbashkëta, vizita në fermë, tregjet e fermerëve dhe më shumë.**





3. Shembuj > 3.4 Dietat dhe të ushqyerit e qëndrueshëm



## 3.4 DIETAT DHE TË USHQYERIT E QËNDRUESHËM

Dietat e qëndrueshme janë të mira për shëndetin publik, mirëqenien dhe për mjedisin. Qytetet mund të promovojnë edukimin e qëndrueshëm dietik dhe aftësitë e gatimit për publikun e gjerë dhe ata që punojnë në sektorin e ushqimit

dhe eksplorojnë instrumente rregullatore dhe vullnetare për të promovuar dieta të përbalueshme, të përshtatshme kulturore dhe të qëndrueshme.

Qytetet e Food Trails kanë punuar për të përmirësuar qëndrueshmërinë e dietave dhe të ushqyerit duke iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme:

1

Çfarë mund të bëjë qyteti im për të edukuar nxënësit rreth dietave të shëndetshme në shkollë?  
Kopenhagë

2

Si mund të promovojë dhe të lehtësojë qyteti im ndryshimin e sjelljes drejt dietave të qëndrueshme?  
Funshal

3

Çfarë njohurish dhe aftësish u duhen qytetarëve dhe stafit të hotelerisë në qytetin tim për të pasur një dietë më të mirë dhe si mund ta mbështesim këtë?  
Groningen





3. Shembuj > 3.4 Dietat dhe të ushqyerit e qëndrueshëm > Kopenhaga



## Çfarë mund të bëjë qyteti im për të edukuar nxënësit rreth dietave të shëndetshme në shkolla?

**Kopenhaga** ka zhvilluar edukimin e sistemit ushqimor në shkolla, duke i mësuar nxënësit për ushqimin e qëndrueshëm dhe dietat e shëndetshme

Zhvillimi i zakoneve të shëndetshme të të ngrënit tek të rinjtë është një hap i rëndësishëm drejt sigurimit të shëndetit dhe mirëqenies në të ardhmen. Shumë qytete të Food Trails po punojnë për të promovuar dieta të shëndetshme përmes menuve të shkollave dhe edukimit për ushqimin. Kopenhaga po punon me studentët, fermerët lokalë dhe kuzhinierët e shkollave për t'u siguruar që studentët të informohen për elementet ushqyese të një diete të shëndetshme, për ndikimin mjedisor të sistemit ushqimor dhe për ushqimet e ndryshme kulturore dhe të rëndësishme.




Kopenhaga ka 650 000 banorë, nga të cilët 65 000 janë studentë. Ai u rendit qyteti i dytë më i jetueshëm në botë nga indeksi global i jetueshmërisë në vitin 2022. Qyteti ka një strategji ushqimore aktive për vitet 2020-2025 dhe një strategji klimatike ambicioze që nga viti 2019. Masat e tyre pilot përqendrohen në prokurimin publik të qëndrueshëm, zhvillimin e materialeve arsimore për shkollat dhe rritjen e ndërgjegjësimit për dieta të shëndetshme.



### 3. Shembuj > 3.4 Dietat dhe të ushqyerit e qëndrueshëm > Kopenhaga



Qyteti i Kopenhagës promovon ngrënie publike ekologjike. Një nga vendet kryesore për këto ndërhyrje është sistemi shkollor. Kuzhinat bashkiake të Kopenhagës përgatisin mbi 115 000 vakte në ditë. Staf i kuzhinës së qytetit po ndryshon menytë për të ulur përmbajtjen e mishit dhe për të promovuar zgjedhje më të shëndetshme dietike. Brenda shumë prej shkollave të qytetit, ushqimi dhe sistemi ushqimor janë në qendër të kurrikulës arsimore. Nxënësit janë të përfshirë në të gjitha fazat. Ata mësojnë për sistemin ushqimor dhe ndikimin e tij në mjedis dhe historinë e kulturave të ndryshme. Të rinjtë punojnë me kuzhinierë për zhvillimin e menisë, përgatitjen e mostrave të pjatave të panjohura dhe nxitjen e bashkëmoshatarëve për të provuar këto ushqime të reja. Shumë prej pjatave pasqyrojnë diversitetin kulturor në rritje të qytetit. Gatimi dhe ndarja e ushqimeve të reja shihet si një mënyrë për të promovuar dieta të qëndrueshme të përshtatshme kulturore dhe për të përqafuar ndryshimet shoqërore përmes ndarjes dhe shijimit të ushqimit. Kopenhaga ka zhvilluar gjithashtu marrëdhënie arsimore novatore me fermerët vendas, si pjesë e planeve të qytetit për të lidhur edukimin e fëmijëve me ushqimin që ata konsumojnë. Me mbështetjen e Food Trails, Kopenhaga ka krijuar lidhje midis studentëve dhe fermerëve, duke i lejuar të rinjtë të mësojnë se si rriten patatet dhe realitetet e bujqësisë.





### 3. Shembuj > 3.4 Dietat dhe të ushqyerit e qëndrueshëm > Kopenhaga



Ky projekt ilustron përpjekjet e qytetit për të zhvilluar tenderë novatorë të prokurimit që përfshijnë një komponent arsimor.

Përpjekjet e Kopenhagës në promovimin e edukimit të shëndetshëm të dietës përballen me sfida më të gjera. Shkollat vërejnë se nxënësit më të rritur shpesh zgjedhin të blejnë ushqimet nga restorantet lokale të ushqimit të shpejtë. Shkollat po punojnë për të zhvilluar zgjedhje të menuse që imitojnë menutë e ushqimit të shpejtë, duke përfshirë përbërës më të shëndetshëm. Mund të nevojiten përpjekje të mëtejshme për të përfshirë aktorët lokalë të sistemit ushqimor përtej shkollave. Qytetet e tjera të Food Trails po merren me këtë çështje duke hartuar legjislacionin që kufizon shitjen e ushqimit të shpejtë pranë shkollave.



**Kopenhaga po punon me fermerët lokalë dhe kuzhinierët e shkollave për të ofruar edukim në lidhje me sistemet ushqimore.**





3. Shembuj > 3.4 Dietat dhe të ushqyerit e qëndrueshëm > Funshal



## Çfarë mund të bëjë qyteti im për të edukuar nxënësit rreth dietave të shëndetshme në shkolla?

**Funshali** po promovon zakone të qëndrueshme dietike përmes shkollave, programeve të shtrirjes në komunitet dhe ndërhyrjeve sociale që trajtojnë pabarazinë

Zhvillimi i zakoneve të qëndrueshme dietike në të gjithë popullsinë kërkon qasje të gjera dhe novatore. Ato mund të mbështeten dhe të forcohen duke lidhur përpjekjet me ndërhyrje të tjera sociale dhe ekonomike. Gjatë gjithë projektit Food Trails, Funshali ka treguar kreativitet dhe angazhim për të ndryshuar zakonet dietike të banorëve të qytetit. Dietat e qëndrueshme janë objektivi qendror i laboratorëve të novacionit të qytetit.

Në fazat e hershme të pandemisë Covid 19, Funshali organizoi shpërndarjen e shportave ndihmëse. Këto shporta përfshinin ushqim të shëndetshëm nga prodhuesit vendas, si dhe këshilla dhe receta për një dietë të shëndetshme.



Funshali, kryeqyteti i ishullit të Madeiras, është një qendër turistike plot jetë me 105 000 banorë. Qyteti mbështet në mënyrë aktive komunitetin përmes nismave të tilla si shporta ndihmëse e Funshalit, e cila ofron ndihmë për familjet me të ardhura të ulëta. Duke përqafuar qëndrueshmërinë, Funshali promovon kopshtarinë urbane, parandalon mbetjen e ushqimit dhe nxit kompostimin gjatë projektit Food Trails.



### 3. Shembuj > 3.4 Dietat dhe të ushqyerit e qëndrueshëm > Funshal



Qyteti ka një program të mirëfilltë të shkollave ekologjike, ku fëmijët mbjellin dhe rrisin perime. Kopshtet përdoren si një mundësi për t'u mësuar fëmijëve rreth prodhimit organik dhe rëndësisë së një diete të shëndetshme.

Funshali përfshin edhe edukimin ushqimor në kuadër të nismave të tjera sociale që mbështesin komunitetet e cenueshme. Kjo është e rëndësishme, pasi këto grupe shpesh përcipen të përballojnë një dietë të shëndetshme dhe janë më të rrezikuara nga sëmundjet jo të transmetueshme për shkak të dietës së dobët. Bashkia promovon edukimin për ushqimin përmes programeve të informimit të komunitetit, çerdheve dhe aktiviteteve në lagjet sociale. Funshali ka një historik të fortë të punës me individë dhe komunitete që përballen me sfida socio-ekonomike dhe po e përdor këtë përvojë për të informuar dhe për të nxitur përpjekjet e saj për të promovuar një dietë të shëndetshme.

Qyteti ka rigjallëruar skemën e tij të ndarjes dhe tani ka caktuar të gjithë hapësirën bashkiake në rritje për individët në nevojë. Toka ka përparësi për individët që përjetojnë varfëri dhe pasiguri ushqimore dhe arsimit sigurohet që njerëzit të mund të rrisin ushqim të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm për veten dhe familjet e tyre.







### 3. Shembuj > 3.4 Dietat dhe të ushqyerit e qëndrueshëm > Funshal



Funshali ka pranuar se ndryshimi i sjelljes duhet të mbështetet me arsim, mundësi për të zhvilluar aftësi të reja dhe një kontekst mbështetës shoqëror që nxit praktika të reja. Duke ofruar edukim në kontekste të shumta dhe të larmishme, si dhe duke u siguruar që njerëzit të kenë përbërësit dhe aftësitë e nevojshme të gatimit, Funshali është një frymëzim në promovimin e ndryshimeve të sjelljes dietike.



Duke ofruar edukim në kontekste të shumta dhe të larmishme, si dhe duke u siguruar që njerëzit të kenë përbërësit dhe aftësitë e nevojshme të gatimit, Funshali është një frymëzim në promovimin e ndryshimeve të sjelljes dietike.



3. Shembuj > 3.4 Dietat dhe të ushqyerit e qëndrueshëm > Groningen



## Çfarë njohurish dhe aftësish u duhen qytetarëve dhe stafit të hotelarisë në qytetin tim për të pasur një dietë më të mirë dhe si mund ta mbështesim këtë?

Groningeni zhvilloi një libër gatimi, karta recetash, seminare dhe trajnime profesionale rreth dietave të shëndetshme

Groningeni është përqendruar në tranzicionin e proteinave në të gjithë laboratorët e tij të novacionit të Food Trails. Për të arritur këtë ndryshim të rëndësishëm në dietat e njerëzve, qyteti njih rëndësinë e punës me komunitetet lokale për t'u siguruar që njerëzit të kenë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të përgatitur vakte të shëndetshme. Përmes punës së afërt me organizatat që mbështesin komunitetet që përballen me pengesa për një dietë të shëndetshme, Groningeni zhvilloi një seri ndërhyrjesh të krijuara për të mbështetur gatimin dhe ushqimin e shëndetshëm.

Gatimi i vakteve të shëndetshme mund të jetë veçanërisht i vështirë për njerëzit me të ardhura të kufizuara.



Groningen

Groningeni, me 235 000 banorë dhe 65 000 studentë (mbi 10 000 studentë ndërkombëtarë), është qyteti më i madh dhe qendra ekonomike e Holandës veriore. Me një shumicë popullsie nën 35 vjeç, është një qytet rinor dhe energjik që mbahet për atraksionet e gjalla kulturore dhe mjedisin e favorshëm për avancimin e praktikave të qëndrueshme ushqimore. Shëndeti, qëndrueshmëria, përfshirja sociale dhe angazhimi i komunitetit janë në themel të zhvillimit të masave pilot të Groningenit.



### 3. Shembuj > 3.4 Dietat dhe të ushqyerit e qëndrueshëm > Groningen



Projekti i librit të gatimit u hartua bashkë me organizata që punojnë drejtpërdrejt me njerëzit që e kanë të vështirë të konsumojnë një dietë të shëndetshme dhe përfshiu përvojën dhe njohuritë e tyre në lidhje me barrierat me të cilat përballen këto grupe në ndjekjen e një diete të qëndrueshme. Groningeni ka shumë studentë dhe shumë emigrantë të kohëve të fundit, të cilëve shpesh u mungojnë fondet për një dietë të shëndetshme.

Groningeni ka bërë një libër gatimi me receta të lehta dhe të lira. Shumica e tyre janë me bazë bimore. Libri i gatimit është shkruar në një gjuhë të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë. Qyteti ka punuar në përfshirjen e njohurive dhe njohjes së gatimit në skemat përkatëse, duke punuar ngushtë me qendrat komunitare dhe duke ofruar trajnime për mësuesit e gatimit. Në qendrat dhe shkollat e komunitetit u ofruan trajnime falas, duke dhënë mësim praktikë gatimi bazuar në recetat në librin e gatimit. Mësimet e gatimit ofrohen gjithashtu në shkollë, me një version për fëmijë të librit të gatimit që është duke u zhvilluar. Kjo do të përdoret edhe në qendrat e komunitetit për të ofruar kurse gatimi për fëmijët. Aftësitë e gatimit janë të rëndësishme kur nxisni dieta të reja pa mish. Qytetet e tjera të Food Trails kanë ofruar trajnime për kuzhinierët e mensave në mënyrë që të mund të përgatiten ushqime të shijshme me bazë bimore në shkollë dhe hapësira të tjera ngrënieje të komunitetit.





### 3. Shembuj > 3.4 Dietat dhe të ushqyerit e qëndrueshëm > Groningen



Përprojekjet e Groningenit për të nxitur kalimin në një dietë të shëndetshme janë përqendruar në sigurimin e aftësive të gatimit për ato grupe që priren të kenë vështirësi të shumta për një dietë të shëndetshme. Qyteti ka punuar ngushtë me organizatat e komunitetit gjatë zhvillimit të ndërhyrjeve të tyre. Shumë shpesh, vaktet me vlera ushqyese shihen si shumë të shtrenjta nga shumë njerëz. Groningeni ka treguar se dieta e shëndetshme mund të arrihet nga kushdo.



Aftësitë e gatimit janë të rëndësishme kur nxisni dieta të shëndetshme duke përdorur përbërës të rinj.



### 3. Shembuj > 3.5 Furnizimi dhe shpërndarja e ushqimit



## 3.5 FURNIZIMI DHE SHPËRNDARJA E USHQIMIT

Qytetet mund të promovojnë qëndrueshmërinë përmes përmirësimit të lidhjeve dhe transportit midis zonave urbane, periferike dhe zonave të afërta të prodhimit të ushqimit. Sistemet e prokurimit mund të nxisin prodhimin agroekologjik

të ushqimit dhe mundësitë e tregut për prodhuesit rajonalë. Mbështetja e tregjeve bashkiake lidh drejtpërdrejt prodhuesit dhe konsumatorët përmes zinxhirëve të shkurtër të furnizimit.

Qytetet e Food Trails kanë punuar për pyetjet e mëposhtme rreth furnizimit dhe shpërndarjes së ushqimit:

1

Si mund ta bëjë qyteti im sistemin tonë publik të hotelerisë më të qëndrueshëm dhe ta përdorë për të mbështetur prodhuesit lokalë agroekologjikë?  
Milano

2

Si mund ta përdorim teknologjinë dhe sistemet dinamike të blerjes për të mbështetur angazhimin e prodhuesve vendorë me sistemin e prokurimit të qytetit?  
Kopenhagë

3

Si mund të forcojmë bashkëpunimin urban-rural në sistemin tonë ushqimor në mënyrë që konsumatorët urbanë dhe prodhuesit ruralë të marrin të gjithë trajtim të barabartë?  
Grenoble Alpes Metropole





3. Shembuj > 3.5 Furnizimi dhe shpërndarja e ushqimit > Milano



## Si mund ta bëjë qyteti im sistemin tonë publik të hotelerisë më të qëndrueshëm dhe ta përdorë për të mbështetur prodhuesit lokalë agroekologjikë?

**Milano** investoi në kuzhina me efikasitet energjetik dhe kontrata të rishikuara të furnizuesve për të integruar qëndrueshmërinë në të gjitha pikat e furnizimit dhe shpërndarjes

Ushqimi bashkiak për shkollat, spitalet dhe vaktet shtëpiake të kujdesit është një temë e rëndësishme për ndërhyrjet në sisteme ushqimit të qytetit. Shumë ndërhyrje përqendrohen në prokurim, duke parë se çfarë lloj ushqimesh blihen dhe si prodhohen. Kjo është e rëndësishme, por mund të bëhet më shumë për t'i bërë sistemet publike të hotelerisë edhe më të qëndrueshme. Milano ka përdorur punën e tij me projektin Food Trails për të kryer një rishikim të plotë të sistemit të tij publik të hotelerisë për të parë se si mund të përmirësojë qëndrueshmërinë e furnizimit, përgatitjes dhe shpërndarjes së ushqimit të qytetit në të gjitha fazat.



Milano, me 1,4 milionë banorë dhe 3,5 milionë në zonën e saj metropolitane, shërben si kryeqyteti ekonomik dhe financiar i Italisë. Qyteti ka 8 universitete me gati 200 000 studentë. Në vitin 2014, Milano krijoi politikën e vet të ushqimit, duke përfshirë krijimin e 10 "Qendrave për reduktimin ushqimit të mbetur". Masat pilot të Milanos përqendrohen në përmirësimin e qarkullimit të sistemeve të mensave të shkollave në bashki, duke ndërhyrë në prokurimin publik dhe reduktimin e mbetjeve.



### 3. Shembuj > 3.5 Furnizimi dhe shpërndarja e ushqimit > Milano



Milano ka pasuri të konsiderueshme të tokës urbane dhe rurale. Qyteti mban një marrëdhënie pune të ngushtë dhe reciprokisht mbështetëse me fermerët që punojnë në fermat bashkiake të tokës dhe mundësoi që ata të siguroheshin me ujë gjatë thatësirës së vitit 2022. Fermerët kanë një treg të garantuar për prodhimet e tyre organike, të cilat përdoren në vaktet publike të qytetit. Milano Ristorazione (MiRi) është në pronësi të qytetit të Milanos dhe menaxhon të gjithë zinxhirin e furnizimit dhe shpërndarjes për sistemin e prokurimit të qytetit. Kur kontrata e qytetit me MiRi-n ishte për rinovim, ajo i dha Milanos një mundësi unike dhe të fuqishme për të eksploruar se si mund të rrisë qëndrueshmërinë në pika të shumta në të gjithë sistemin e furnizimit dhe shpërndarjes. Kjo u bazua në përpjekjet e mëparshme për të pakësuar mishin, kripën dhe sheqerin në vaktet publike. Milano dhe MiRi punuan me Food Trails për të zvogëluar plastikën dhe paketimin në të gjithë sistemin e shpërndarjes së mensës së shkollës. Qyteti zbuloi se si MiRi mund të furnizonte mbi 80 000 vakte në ditë, duke minimizuar plastikën dhe mbetjet dhe duke përmirësuar qëndrueshmërinë në të gjithë sistemin e saj të shpërndarjes. Kjo krijoi një mundësi unike për të shkuar përtej kuptimeve të përbashkëta të sistemit të furnizimit dhe shpërndarjes, të cilat kanë tendencë të përqendrohen në llojet e ushqimit të furnizuar dhe mënyrën e prodhimit të tyre.





### 3. Shembuj > 3.5 Furnizimi dhe shpërndarja e ushqimit > Milano



MiRi ka platformën e vet logjistike për përgatitjen dhe shpërndarjen e vakteve në mjediset publike në të gjithë qytetin. Kjo përfshin furgonë frigoriferikë dhe qendra kuzhine. Gjatë pandemisë Covid-19, qyteti shfrytëzoi rastin për të rinovuar një nga kuzhinat dhe qendrat e shpërndarjes së MiRi-t. Kjo përfshinte instalimin e ndriçimit me efikasitet energjetik dhe një sistem të rikuperimit të nxehtësisë. Uji i përdorur në kuzhina filtrohet, me yndyrat që u dërgohen tretësve biologjikë. Çdo ushqim i mbetur në mënyrë të pashmangshme dërgohet për t'u përpunuar dhe për t'u kthyer në biokarburante.



Përmes rishikimit të marrëdhënies së tyre të punës me MiRi-n dhe rinovimit të një prej kuzhinave të tyre kryesore, Milano ka bërë përpertime të rëndësishme në bërjen e furnizimit dhe shpërndarjes së ushqimit në të gjithë sistemin e tij publik të hotelerisë më të qëndrueshëm në të gjitha pikat.



**Milano po përmirëson qëndrueshmërinë në të gjitha fazat e sistemit të saj publik të hotelerisë, duke përfshirë prodhimin, përgatitjen, shpërndarjen dhe menaxhimin e mbetjeve.**







3. Shembuj > 3.5 Furnizimi dhe shpërndarja e ushqimit > Kopenhagë



## Si mund ta përdorim teknologjinë dhe sistemet dinamike të blerjes për të mbështetur angazhimin e prodhuesve vendorë me sistemin e prokurimit të qytetit?



**Kopenhaga** përdori teknologjinë e informacionit për të mundësuar pjesëmarrjen e më shumë furnizuesve në kontratat bashkiake.

Kopenhaga ka një reputacion të fortë për nivele të larta të produkteve organike të përdorura brenda sistemit të vet të prokurimit. Sidoqoftë, furnizimi dhe shpërndarja e ushqimit organik shpesh favorizon sisteme në shkallë të gjerë dhe nuk arrin të ofrojë përfitime më të gjera për ekonomitë rajonale ose mundësi për prodhuesit në shkallë më të vogël, të cilët po punojnë për të përfshirë gjithashtu qëllime më të gjera transformuese socio-ekonomike brenda bizneseve të tyre. Në mënyrë të ngjashme, prodhimi i ushqimit organik mund të jetë më i shtrenjtë se sistemet e zakonshme ushqimore. Vendimmarrja e bazuar vetëm në çmim mund të përfshijë mospërputhje të fuqisë që favorizojnë prodhuesit në shkallë të gjerë dhe nuk arrijnë të mbështesin ekonomitë lokale.



Kopenhaga ka 650 000 banorë, nga të cilët 65 000 janë studentë. Ai u rendit qyteti i dytë më i jetueshëm në botë nga indeksi global i jetueshmërisë në vitin 2022. Qyteti ka një strategji ushqimore aktive për vitet 2020-2025 dhe një strategji klimatike ambicioze që nga viti 2019. Masat e tyre pilot përqendrohen në prokurimin publik të qëndrueshëm, zhvillimin e materialeve arsimore për shkollat dhe rritjen e ndërgjegjësimit për dieta të shëndetshme.





### 3. Shembuj > 3.5 Furnizimi dhe shpërndarja e ushqimit > Kopenhagë



Gjatë projektit Food Trails, Kopenhaga punoi për të forcuar zinxhirët më të shkurtër të vlerës që u mundësojnë prodhuesve vendorë të furnizojnë sistemin e prokurimit të qytetit.

Kopenhaga ka mbi 1000 kuzhina publike në të gjithë qytetin. Shkurtimi i zinxhirëve të vlerës kërkonte përmirësimin e komunikimit dhe të bashkëpunimit në të gjithë ekipin ushqimor të qytetit, si dhe kuzhinierët, furnizuesit dhe prodhuesit. Kopenhaga po zhvillon zgjidhje teknologjike për të lehtësuar bashkëpunim më të mirë, si dhe mundësi të zgjeruara ekonomike për prodhuesit e vegjël. Në kuadër të projektit të BE-së COACH, Kopenhaga ka punuar në zhvillimin e një sistemi dinamik blerjesh. Duke zhvilluar teknologji të lehtë për t'u përdorur dhe transparente, qyteti synon të forcojë produktivitetin bujqësor të prodhuesve të vegjël, dhe aftësinë e tyre për të furnizuar drejtpërdrejt kuzhinat dhe shkollat. Nëpërmjet Food Trails, qyteti ka zhvilluar edhe një aplikacion të lehtë për t'u përdorur që minimizon hendekun midis zyrës qendrore të prokurimit dhe kuzhinave, duke u dhënë pronarëve të kontratës njohuri më të mira të asaj që ndodh kur dorëzohen mallrat.



**Kopenhaga punoi për të forcuar zinxhirët më të shkurtër të vlerës që u mundësojnë prodhuesve vendorë të furnizojnë sistemin e prokurimit të qytetit.**



3. Shembuj > 3.5 Furnizimi dhe shpërndarja e ushqimit > Grenoble Alpes Metropole



## Si mund të forcojmë bashkëpunimin urban-rural në sistemin tonë ushqimor në mënyrë që konsumatorët urbanë dhe prodhuesit ruralë të marrin të gjithë trajtim të barabartë?

Projekti ndërterritorial i ushqimit **Grenoble Alpes Metropole** lidh komunat dhe bizneset lokale

Shumë partnerë të Food Trails kanë punuar për të forcuar marrëdhëniet midis komunave dhe bizneseve lokale, puna e të cilëve ndikon në qëndrueshmërinë e sistemit rajonal të ushqimit. Grenoble Alpes Metropole ka zhvilluar projektin ndërterritorial të ushqimit (PAIT) i cili punon me një gamë të gjerë aktorësh të qeverisë dhe sektorit privat. Qëllimi i PAIT-it është të sigurojë që fermerët të paguhen mirë dhe të kenë mundësi tregu për ushqimet e tyre të prodhuara në mënyrë të qëndrueshme. Metropole bashkëpunon në sektorë të ndryshëm dhe i ka integruar këto synime në shërbimet e tyre të përbashkëta të hotelierisë.



Grenoble Alpes Metropole ka 480 000 banorë dhe 65 000 studentë, të shpërndarë në 49 bashki. I njohur si Kryeqyteti i Gjellbër Evropian në vitin 2022, Metropole kontribuon në nxitjen e një sistemi të qëndrueshëm ushqimor si anëtar i Paktit të Politikës Urbane të Ushqimit në Milano. Që nga viti 2020, Metropole organizon një muaj të tranzicionit të ushqimit për të rritur ndërgjegjësimin te qytetarët. Masat e tjera pilot gjatë Food Trails po promovojnë një tranzicion të qëndrueshëm në mensat e shkollës dhe zhvillimin e një këshilli ndërterritorial të ushqimit me bashkitë e tij.



### 3. Shembuj > 3.5 Furnizimi dhe shpërndarja e ushqimit > Grenoble Alpes Metropole



Edhe pse Franca tani ka ligjin Egalim, i cili vendos objektiva ambicioze për bashkitë për të përdorur ushqimin e prodhuar në vend në sistemin e prokurimit publik dhe për të reduktuar përdorimin e plastikës dhe mbetjet ushqimore, shumë prej tyre kanë konstatuar se zbatimi i këtyre ligjeve mund të jetë mjaft sfidues. Grenoble Alpes Metropole po punon me sektorin privat për të zhvilluar një ekonomi të fortë lokale për ushqimin. Plani i veprimit për strategjinë bujqësore dhe ushqimore thekson rolin e bizneseve të prodhimit, të përpunimit dhe të shpërndarjes, si dhe rëndësinë e investimit të Metropole në mbështetjen e këtyre sektorëve. Metropole është angazhuar të mbështesë bizneset rajonale të ushqimit dhe të mbështesë restorantet për të marrë certifikimin e qëndrueshmërisë që shpërblen përpjekjet e tyre për të ulur mbetjet e ushqimit dhe për të përdorur prodhimet agroekologjike në menutë e tyre. Ata po punojnë edhe me fermat lokale për t'u siguruar që tokat bujqësore të qëndrojnë në prodhim. Kjo është një sfidë e zakonshme për qytetet e Food Trails, pasi moshë mesatare e fermerëve është relativisht e lartë dhe shumë prej tyre nuk kanë plane të njëpasnjëshme që një brez i ri të marrë përsipër fermën. Grenoble Alpes Metropole po mbështet fermat në zhvillimin e kanaleve të shitjeve të drejtpërdrejta për konsumatorët. Kjo mbështet fermerët në ruajtjen e përfitimit maksimal ekonomik nga prodhimet e tyre.





### 3. Shembuj > 3.5 Furnizimi dhe shpërndarja e ushqimit > Grenoble Alpes Metropole



Metropole ka mbështetur gjithashtu zhvillimin e markës IsHère, e cila tregton produkte vendase, cilësore, synon të dyfishojë numrin e prodhuesve të përfshirë dhe të trefishojë shitjet vjetore. Do të ketë një fokus të veçantë në tregtimin e prodhimeve organike vendore.

Vlerësimi i hollësishëm i Grenoble Alpes Metropole për sistemin e tij bujqësor territorial dhe pozicionin ekonomik dhe demografik, i kanë mundësuar asaj të zhvillojë një sistem mbështetës bashkiak për bizneset ushqimore lokale të qëndrueshme. Kjo është si shtesë e punës së Metropole për prokurimin për furnizimin e ushqimit në shkolla, përmes së cilës i jepet përparësi një diete të shëndetshme dhe ekologjike së bashku me burimet nga prodhuesit vendas.



**Grenoble Alpes Metropole  
po mbështet fermat në  
zhvillimin e kanaleve të  
shitjeve të drejtpërdrejta për  
konsumatorët.**







3. Shembuj > 3.6 Barazia sociale dhe ekonomike



## 3.6 BARAZIA SOCIALE DHE EKONOMIKE

Problemet e sistemit ushqimor urban shpesh lidhen me pabarazinë sociale dhe ekonomike. Qytetet duhet të përfshijnë nisma ushqimore brenda aktiviteteve sociale dhe solidaritetit. Promovimi dhe mbështetja e bazës dhe qasjet

novatore ndihmojnë në sigurimin e qasjes së barabartë në ushqim të shëndetshëm për të gjithë. Barazia sociale dhe ekonomike është një sfidë e madhe për shumë qytete.

Qytetet e Food Trails kanë punuar për pyetjet e mëposhtme rreth kësaj çështjeje:

1

Si mund t'i lidhë qyteti im nismat për ushqimin me nismat më të gjera sociale dhe ekonomike?

Groningen

2

Për çfarë informacioni kanë nevojë politikanët e mi lokalë për të kuptuar pabarazinë në sistemin ushqimor dhe çfarë mund të bëjnë ata për të mbështetur ndryshimet?

Bergamo

3

Si mund të sigurohet qyteti im që qytetarët e cenueshëm, duke përfshirë fëmijët, njerëzit me të ardhura të ulëta dhe ata që janë të pastrehë të kenë ushqim të shëndetshëm?

Tiranë



3. Shembuj > 3.6 Barazia sociale dhe ekonomike > Groningen



## Çfarë njohurish dhe aftësish u duhen qytetarëve dhe stafit të hotelarisë në qytetin tim për të pasur një dietë më të mirë dhe si mund ta mbështesim këtë?

Puna e **Groningenit** për ushqimin i vendos njerëzit, komunitetin dhe drejtësinë në qendër të nismave të tyre

Vështirësitë për të pasur një dietë të shëndetshme shpesh lidhen me sfida më të gjera sociale dhe ekonomike që përjetojnë njerëzit. Shumë qytete të Food Trails po punojnë për të trajtuar pasigurinë ushqimore duke lidhur nismat për ushqimin me programe më të gjera sociale. Këto programe shpesh janë krijuar nga organizatat e komunitetit, të cilët kanë njohuri të shkëlqyera për vështirësitë që kanë njerëzit lokalë.

Groningeni ka marrëdhënie të forta pune me shumë nisma të sektorit të tretë në qytet. Duke krijuar aleanca strategjike me këto grupe, bashkia ka zhvilluar një sërë projektesh që adresojnë pengesat e njerëzve për një dietë të shëndetshme si pjesë e vështirësive më të gjera që ata përjetojnë.



Groningen

Groningeni, me 235 000 banorë dhe 65 000 studentë (mbi 10 000 studentë ndërkombëtarë), është qyteti më i madh dhe qendra ekonomike e Holandës veriore. Me një shumicë popullsie nën 35 vjeç, është një qytet rinor dhe energjik që mbahet për atraksionet e gjalla kulturore dhe mjedisin e favorshëm për avancimin e praktikave të qëndrueshme ushqimore. Shëndeti, qëndrueshmëria, përfshirja sociale dhe angazhimi i komunitetit janë në themel të zhvillimit të masave pilot të Groningenit.



### 3. Shembuj > 3.6 Barazia sociale dhe ekonomike > Groningen



Bashkia gjithashtu mbështet projekte që janë nisur nga qytetarë që kuptojnë nevojat e komunitetit lokal, dhe që kanë një vizion të qartë dhe transformues se si të promovohet qëndrueshmëria. Shumë nga këto projekte janë të vendosura në zonën e Westpark-ut, i cili është vendi i disa nismave sociale. Kjo përfshin nismën *Tuin in de Stad*, e cila punon në nivele të ndryshme: restoranti i saj social organizon darka javore, një kopsht komuniteti kultivohet nga individë që janë pa punë dhe përjetojnë varfëri dhe sfida të tjera sociale dhe hapësirat e gjelbra ofrojnë mundësi për fëmijët dhe të tjerët që të relaksohen dhe të kënaqen duke qëndruar jashtë. Pylli i ushqimit në Westpark ka një qëllim arsimor, duke treguar prodhimin e ushqimit me ndikim të ulët që është integruar brenda një hapësire publike ku natyra dhe prodhimi i ushqimit janë të lidhura dhe një burim i përbashkët për të gjithë. Vullnetarët ftohen të punojnë në kopshtin *Blijde Bodem (Tokë e lumtur)* të Westpark-ut dhe të frymëzohen nga mjedisi i tij paqësor, si dhe të ndajnë prodhimet e tij.







### 3. Shembuj > 3.6 Barazia sociale dhe ekonomike > Groningen



Shumë qytete janë shtëpia e komuniteteve që janë në rrezik varfërie, izolimi social dhe shëndeti të dobët. Kjo përfshin të moshuarit, familjet me një prind, ardhjet e reja në qytet dhe njerëzit me probleme kronike shëndetësore. Duke lidhur nismat për ushqimet me programe që gjithashtu adresojnë sfida të tjera, qytetet mund të adresojnë në mënyrë efektive sfida të shumta në të njëjtën kohë.



Duke krijuar aleanca strategjike me grupet e komunitetit, Groningeni ka zhvilluar një sërë projektesh që trajtojnë pengesat e njerëzve për një dietë të shëndetshme, si dhe adresojnë vështirësitë më të gjera që ata përjetojnë.





3. Shembuj > 3.6 Barazia sociale dhe ekonomike > Bergamo



## Për çfarë informacioni kanë nevojë politikanët e milokalë për të kuptuar pabarazinë në sistemin ushqimor dhe çfarë mund të bëjnë ata për të mbështetur ndryshimet?

Ushtrimi i hartëzimit të **Bergamos** theksoi risitë e sistemit ushqimor transformues nga ana shoqërore

Në mënyrë që qytetet të veprojnë me sukses në barazinë sociale dhe ekonomike dhe ndikimin e saj në sistemin e tyre ushqimor, politikanët duhet të informohen për marrëdhëniet midis pabarazisë, shëndetit publik dhe pasigurisë ushqimore. Ata gjithashtu duhet të jenë të vetëdijshëm për shumë organizata bazë që po punojnë për të adresuar këto sfida, për të mbështetur krijimin e aleancave efektive midis qeverisjes lokale dhe projekteve që punojnë për ushqimin brenda një konteksti më të gjerë shoqëror. Grupe të tilla janë shpesh të vogla, me burime të kufizuara dhe jo shumë të njohura jashtë komunitetit të tyre të menjëhershëm.



Bergamo ka 121 000 banorë, duke përfshirë mbi 23 000 studentë. U emërua qytet kreativ i gastronomisë nga UNESCO në vitin 2019. Qyteti ka një këshill aktiv të politikave ushqimore dhe ka organizuar festivalin "Bujqësia dhe e drejta për ushqim" që nga viti 2017. Masat e tyre pilot adresojnë edukimin ushqimor, qëndrueshmërinë e sistemit të mensës së shkollës dhe prokurimin.



### 3. Shembuj > 3.6 Barazia sociale dhe ekonomike > Bergamo



Duke theksuar nismat lokale, bashkia mund t'i mbështesë ato në mënyrë më efektive dhe të kuptojë më mirë nevojat lokale.

Si pjesë e projektit Food Trails, Bergamo kreu një vlerësim të hollësishëm të sistemit ushqimor të qytetit të saj. Kjo u siguroi politikanëve informacion mbi shkallën e sfidave me të cilat përballlet qyteti, siç është numri i familjeve që kanë pasiguri ushqimore dhe vendet e qytetit ku njerëzit kanë më shumë nevojë për mbështetje. Bergamo gjithashtu mblodhi informacion mbi zgjidhjet krijuese për barazinë sociale dhe ekonomike në sistemin ushqimor të cilat po ndodhnin. Për shembull, projektet e bujqësisë urbane të Bergamos janë të pozicionuara në kuadër të nismave më të gjera sociale. Toka e bashkisë për rritjen e ushqimit u caktohet shoqatave që kanë deklaruar qëllime sociale, të tilla si trajtimi i varfërisë dhe mbështetja e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara.





### 3. Shembuj > 3.6 Barazia sociale dhe ekonomike > Bergamo



Analiza e sistemit ushqimor të Bergamos përfshinte gjithashtu informacion mbi projektet që ofrojnë ushqim të shëndetshëm të përballueshëm për konsumatorët dhe garantojnë një çmim të drejtë për prodhuesit. Shumë prej tyre janë të lidhura me rrjetin Gruppo Acquisto Solidale (GAS) të Italisë. Duke theksuar këto rrjete alternative ushqimore dhe duke punuar për t'i mbështetur ato në nivel komunal, qytetet mund të rrisin ndërgjegjësimin midis politikanëve për sfidat me të cilat përballen qytetarët dhe mënyrat e përmirësimit të jetës së tyre dhe qasjes në ushqim të shëndetshëm dhe të përballueshëm.



**Duke theksuar nismat lokale, bashkia mund t'i mbështesë ato në mënyrë më efektive dhe të kuptojë më mirë nevojat lokale.**





3. Shembuj > 3.6 Barazia sociale dhe ekonomike > **Tiranë**



**Si mund të sigurohet qyteti im që qytetarët e cenueshëm, duke përfshirë fëmijët, njerëzit me të ardhura të ulëta dhe ata që janë të pastrehë të kenë ushqim të shëndetshëm?**



**Tirana** siguron ushqim të shëndetshëm në shkolla dhe qendra sociale

Shumë qytete në Food Trails dhe më gjerë përballen me sfidën për t'u siguruar që të gjithë qytetarët të kenë qasje në ushqim të shëndetshëm. Tirana e ka bërë sigurimin e ushqimit të shëndetshëm për të rinjtë një nga qëllimet e saj kryesore të laboratorit të novacionit. Qyteti ka nivele të larta varfërie, me nivele të lidhura me pasigurinë ushqimore dhe kequshqyerjen. Për ta adresuar këtë problem, qyteti ka zhvilluar një sërë ndërhyrjesh brenda dhe rreth shkollave për të përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve. Bashkia punon me nutricionistë që kanë hartuar menu të balancuara që plotësojnë nevojat e veçanta të fëmijëve të vegjël deri në 6 vjeç.



Tirana, me 500 000 banorët e saj, përbën 20% të popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë. Qyteti zbaton rregulloret kombëtare të zonimit për institucionet e ushqimit të shpejtë dhe është shtëpia e projektit të rinovimit urban "Pazari i ri", i cili mbështet fermerët dhe restorantet lokale. Tirana ka edhe shtatë qendra shoqërore, multidisiplinare të komunitetit. Masat e tyre pilot synojnë të rrisin ndërgjegjësimin për dietat e shëndetshme dhe reduktimin e mbetjeve ushqimore urbane.





### 3. Shembuj > 3.6 Barazia sociale dhe ekonomike > Tiranë



Ushqimi i shëndetshëm sigurohet dhe shërbehet në kopshte, duke siguruar që të gjithë fëmijët të kenë qasje në një vakt të shëndetshëm. Tirana gjithashtu ofron ushqime të përballueshme dhe të shëndetshme përmes një rrjeti qendrash sociale që mbështesin grupet e cenueshme, duke përfshirë njerëzit e pastrehë, individët me të ardhura të ulëta dhe fëmijët e rrugës.

Tirana po punon gjithashtu për të përmirësuar përmbajtjen e vakteve të ofruara në shkolla dhe qendra sociale. Nutricionistët janë të përfshirë në planifikimin e menuse për t'u siguruar që ato përmbushin standardet themelore ushqyese. Por një nga mësimet më të rëndësishme të marra nga shumë qytete të Food Trails është potenciali për të kombinuar ambicie të shumta në ndërhyrje të ndryshme. Mund të sigurohet barazia sociale dhe ekonomike dhe qasja në ushqim të shëndetshëm për konsumatorët, duke mbështetur gjithashtu prodhuesit vendas. Tirana po punon për zhvillimin e sektorit bujqësor rajonal. Ekzistojnë mundësi të mëtejshme për të përfshirë prodhimet nga fermerët vendas në ushqimin e përgatitur për kopshte dhe qendra sociale.





### 3. Shembuj > 3.6 Barazia sociale dhe ekonomike > Tiranë



Kjo do të sillte përfitime të mëtejshme sociale dhe ekonomike në të gjithë sistemin ushqimor vendor. Ka pasur gjithashtu diskutime për të siguruar që teprica e ushqimit nga supermarketet të mblidhet dhe të rishpërndahet për ata në nevojë. Kjo do të ndihmonte Tiranën të ulte mbetjet e saj ushqimore duke siguruar ushqim për ata që kanë vështirësi për një dietë të shëndetshme.



Ekzistojnë mundësi për të përfshirë prodhimet nga fermerët vendas në ushqimin e përgatitur për kopshte dhe qendra sociale.

## 4. MJETET





Mjetet janë zhvilluar dhe përdorur në kuadër të projektit Food Trails për të mbështetur qytetet në zhvillimin e ndërhyrjeve të sistemit ushqimor dhe matjen e ndikimit të tyre. Mjetet janë të lidhura me elementet në QuickScan Lens for Replication (QSLR) dhe ofrojnë udhëzime për planifikimin, zhvillimin dhe zbatimin e proceseve transformuese në sistemin ushqimor të qyteteve tuaja.

Një sërë mjetesh janë prezantuar shkurtimisht në këtë manual. Nëse dëshironi t'i eksploroni mjetet më në thellësi ose t'i zbatoni ato në qytetin tuaj, [materiali bazë në depon online të projektit](#) do të ofrojë më shumë udhëzime dhe shembuj se si janë aplikuar mjetet në Food Trails”.

### 1. HARTËZIMI I GRUPEVE TË INTERESIT

Për të kuptuar aktivitetet aktuale të sistemit ushqimor dhe grupet e interesit në qytetin tuaj, si dhe për të zhvilluar strategji efektive të angazhimit të grupeve të interesit.

### 2. PLAN VEPRIMI PËR POLITIKAT E USHQIMIT

Për të përkthyer fushat e politikave dhe vizionet e lidhura me ushqimin në veprime të detajuara dhe konkrete, si dhe për të identifikuar grupet e interesit me të cilat duhet të punoni për të adresuar në mënyrë efektive kategoritë e Food 2030.

### 3. RRJETI HARTOGRAFIK I QEVERISJES NË SHUMË NIVELE

Hartëzoni marrëdhëniet vertikale dhe horizontale të punës në kategoritë e ndryshme të veprimit të MUFPP-së, si dhe politikat dhe nivelet përkatëse të qeverisjes që ndikojnë në veprimet tuaja.

### 4. TEORIA E NDRYSHIMIT

Për të ilustruar se si aktivitetet në faza të ndryshme do të sjellin ndryshimet e synuara që çojnë në rezultatin tuaj të planifikuar.

### 5. MBLEDHJA E TË DHËNAVE

Udhëzime për të kuptuar situatën aktuale dhe rezultatin e aktiviteteve tuaja: kjo ndihmon për të vendosur se ku të investoni burime të mëtejshme dhe ofron informacion të rëndësishëm për grupet e interesit në lidhje me arritjet.

### 6. UDHËRRËFYESI PËR SHKALLËZIMIN E INVESTIMIT TË NDIKIMIT

Për të mbështetur zgjerimin dhe përshejtimin e investimeve për të nxitur ndryshimin në sistemet ushqimore, duke krijuar përfundimisht mundësi për partneritete afatgjata.

### 7. MËSIMET NGA BASHKUDHËTARËT

Për të shkëmbyer përvoja dhe për të mësuar nga njëri-tjetri.

### 8. MONITORIMI REFLEKSIV

Për të nxitur të mësuarit dhe përshtatjen ndaj problemeve komplekse gjatë një projekti.






## 4. Mjetet &gt; 4.1 Hartëzimi i grupeve të interesit

## 4.1 HARTËZIMI I GRUPEVE TË INTERESIT

### Çfarë është hartëzimi i grupeve të interesit?

Hartëzimi i grupeve të interesit është një lloj analize e palëve të interesuara. Ai përfshin identifikimin e individëve ose organizatave (grupeve të interesit) që janë të interesuara ose të prekura nga nismat që do të ndërmerreni. Grupet e interesit shpesh janë shumë aktive në sistemet ushqimore të qyteteve. Identifikimi dhe hartëzimi i këtyre grupeve të interesit forcon kapacitetin e qyteteve për të njohur se çfarë po bëhet në sistemet e tyre ushqimore dhe çfarë duhet të bëhet tjetër për të rritur punën e grupeve lokale të interesit.

### Matrica e grupeve të interesit





#### 4. Mjetet > 4.1 Hartëzimi i grupeve të interesit

### Si ta bëni hartëzimin e grupeve të interesit?

Së pari, identifikoni të gjitha grupet përkatëse të interesit: merrni parasysh të gjithë individët dhe organizatat potencialisht të prekura, duke përfshirë bizneset, OJQ-të, organet qeveritare dhe grupet e komunitetit. Pastaj, kategorizojini këto grupe interesi sipas nivelit të tyre të ndikimit (fuqia për të ndikuar në projekt) dhe nivelit të tyre të interesit (shqetësimi për rezultatin e projektit). Kjo mund të bëhet duke përdorur një matricë me ndikim të lartë/të ulët dhe kuadrate interesi. Sigurohuni që të merrni parasysh dinamikën e fuqisë: pranoni që grupet e interesit mund të kenë nivele të ndryshme të fuqisë dhe disa mund të hezitojnë të marrin pjesë për shkak të këtij çekuilibri.

### Këshilla për zbatim të suksesshëm

